



This Project is funded
by the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



BALKAN
REFUGEE AND
MIGRATION
COUNCIL

DRC DANISH
REFUGEE
COUNCIL

RAPORT STUDIMOR

Fenomeni i kalimit të paligjshëm të kufirit dhe ndihmës ndaj tij, nën perspektivën e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore (Sarandë, Korçë, Shkodër, Pogradec dhe Përmet)

Tetor 2023
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Hartimi i këtij Raporti Studimor realizohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht ato tëasnjë aktori institucional apo donatori.

Përgatitën Raportin Studimor:

1. Znj. Safete Qato, Eksperte e jashtme Ligjore
2. Znj. Senada Aliu, Eksperte e jashtme Ligjore

Rishikoi:

1. Znj. Ardita Kolmarku, Juriste/Menaxhere Projektesh, KShH
2. Z. Erdion Maçolli, Avokat i KShH

Supervizim dhe Redaktim Ligjor:

Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10,

Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752;

Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;

E-mail:office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

PËRMBAJTJA E PUNIMIT

1. Hyrja	3
2. Metodologjia e Punimit	5
Përmbledhje Ekzekutive	6
SEKSIONI I.....	11
“DINAMIKAT E DY FENOMENEVE TË NDRYSHME KRIMINALE” ‘Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror’ dhe ‘Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve’	11
1.1 Figurat e veprave penale të konsumuara nga të pandehurit	11
1.1.1 Elementët e përbashkët dhe dallimet ndërmjet këtyre dy figurave të veprave penale 12	
1.1.2 Ndërlidhja me veprat e tjera penale.....	14
1.1.3 Ana objektive.....	15
1.1.4 Ana subjektive	17
1.1.5 Pasojat e ardhura nga kryerja e veprave penale.....	19
1.2 Subjektet e dyshuara si autor të veprave penale.....	19
1.2.1 Të pandehurit me statusin e funksionarit publik.....	20
1.2.2 Femrat dhe të miturit si autorë dhe viktime të veprave penale.....	20
1.2.3 Llojet e masave të sigurimit personal të kërkuara dhe aplikuar ndaj të pandehurve 21	
1.2.4 Format e bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe roli i të pandehurve.....	22
1.2.5 Kërkesat për gjykim të shkurtuar dhe efektet e tij.....	23
SEKSIONI 2	24
“POLITIKA PENALE E NDJEKUR NGA INSTITUCIONI I PROKURORISË DHE GJYKATA”	24
1.3 Llojet dhe masat e dënimit të caktuara nga ana e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore.....	24
1.3.1 Trendi i caktimit të alternativave të dënimit me burgim	25
1.3.2 Zbatimi i dënimit penal me gjobë	27
1.3.3 Cilësia e arsytimit të përdorur nga ana e trupave gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore	28
1.3.4 Raste të shpalljes së pafajësisë	29
1.4 Politika penale ndaj të shtetasve nga vendet e treta, të gjykuar pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore shqiptare.....	30
1.4.1 Shqipëria vend tranzit apo destinacion?.....	32
Rekomandime dhe Sugjerime:.....	34
Aneks 1- Lista e vendimeve të analizuara.....	35

1. Hyrja

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në përmbushje të misionit të tij, për të kontribuar në respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe forcimin e shtetit të së drejtës, ka në fokus të veprimtarisë së tij monitorimin periodik të masave të ndërmarra nga ana e institucioneve përgjegjëse shtetërore në vendin tonë, për parandalimin dhe luftën efektive të fenomenit të kontrabandimit të migrantëve, e njohur ndryshe në kontekstin e legjislacionit shqiptar si dhënia e ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit.

KShH ka publikuar më herët dy raporte studimore, të cilat kanë trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe analitike situatën e respektimit të të drejtave dhe lirive të emigrantëve, azilkërkuessve dhe refugjatëve në Shqipëri për periudhën 2012-2017¹; shtator 2018 – qershor 2019². Gjithashtu, KShH ka kontribuar për Shqipërinë në analizën migratore rajonale ‘Politikat e përbashkëta të migracionit në Ballkanin Perëndimor’, publikuar në Tetor 2022.³

Fenomeni i kontrabandimit të migrantëve përbën një kërcënim serioz për sigurinë e kufijve të Republikës së Shqipërisë, por edhe një rrezik konkret ndaj respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Kalimi i kufirit territorial, tokësor apo ajror të një shteti në mënyrë të paligjshme paraqet një dukuri mjaft të shpeshtë, me të cilën përballen të gjitha vendet rajonale, shtetet europiane dhe më gjerë, pavarësisht demokratizimit të politikave penale parandaluese dhe ndëshkimore që qeveritë kanë ndërmarrë. Një numër i lartë i shtetasve përpiqen që të hyjnë në territorin e një shteti, në shkelje të kriterëve ligjore të parashikuara⁴, duke çenuar në këtë mënyrë objektin e marrëdhënieve juridike të përcaktuara si rojtare të paprekshmërisë territoriale shtetërore.

Dinamika e përhapjes së këtij fenomeni nuk është konstante, ndërkohë që bazuar në Strategjinë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit reflektohet se gjatë periudhës 2014-2020, nga ana e Policisë Kufitare dhe Migracionit, janë evidentuar 231 raste të dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, dhe 3985 raste të kalimit të paligjshëm të kufirit⁵.

Në raportin e parë *Screening* të Komisionit Evropian për Shqipërinë (24 Korrik 2023), i cili njihet ndryshe si procesi i kontrollit analitik të *acquis* apo legjislacionit të Bashkimit Evropian (BE)⁶, vërehet se Shqipëria ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (2021-2027) dhe planin e saj të veprimit 2021-2023. Ministria e Brendshme ka përditësuar planin e saj të emergjencës për një numër të konsiderueshëm të mundshëm ardhjesh të emigrantëve dhe azilkërkuessve, por plani ende nuk është miratuar. Stafi i përgjithshëm i Departamentit të Kufirit dhe Migracionit në Policinë Shqiptare të Shtetit mbetet i kufizuar, pavarësisht rritjeve të fundit. Strukturat e përhershme të trajnimit duhet të krijohen në përputhje me standardet bazë të trajnimit për rojet kufitare të BE-së. Krimet që gjenerojnë shumta të mëdha parash përfshijnë trafikun e

¹ Publikuar në Korrik 2018: <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2018/09/Migrantet-Shqip.pdf>

² Publikuar në Mars 2020: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/03/Raport-monitorimi_Mbi-te-drejtat-dhe-lirite-e-emigranteve-azilkerkuesve-dhe-refugjateve-ne-Shqiperi_compressed.pdf

³ <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/11/Politikat-e-Perbashketa-te-Migracionit-ne-Ballkanin-Perendimor-Tetor-2020.pdf>

⁴ Sipas ligjit Nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” (i ndryshuar), me termin ‘kontroll kufitar’ parashikohet *veprimtaria që kryhet në përputhje dhe për qëllim të këtij ligji në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë, si përgjigje posaçërisht ndaj një synimi për të kaluar ose aktit të kalimit të kufirit, pavarësisht nga rrethanat dhe që përbëhet nga verifikimi kufitar e mbikëqyrja kufitare.*

⁵ Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe plani i veprimit 2021–2027

⁶ [Microsoft Word - AL Cluster_1 Draft screening report_external version \(europa.eu\)](#)

drogës, evazionin fiskal, kontrabandën dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Që nga viti 2018, Policia e Kufirit dhe Migracionit nuk ka kompetenca hetimore; për rrjedhojë, asnjë strukturë specifike nga policia kufitare nuk është e angazhuar në hetimin e veprave penale të lidhura me krimet kufitare. Kjo pengon veçanërisht zbulimin e rasteve të kontrabandës dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

Sipas raportit të Agjencisë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX) periudha kohore 2015-2017 shënoi rënie të numrit të emigrantëve të parregullt, por vitet 2018-2020 shënuan një trend rritjeje me hapa të shpejtë, duke e bërë Shqipërinë përsëri një nga urat e lidhjes më të përdorura për kalimin e paligjshëm të emigrantëve midis shteteve si Greqia dhe Turqia, drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Numri i madh i pikave kufitare, vështirësia e relievit, fluksi i lartë i personave dhe mungesa e personelit të trajnuar të kontrollit kufitar janë disa nga faktorët që e shndërrojnë vendin tonë, në një juridiksion të përshtatshëm për kalim të paligjshëm të kufirit.⁷

Nisur nga të dhënat e mësipërme, KShH ndërmoi iniciativën për të monitoruar praktikën gjyqësore të organeve përgjegjëse të sistemit të drejtësisë penale, në kuadër të hetimit dhe gjykimin të veprave penale të kalimit të paligjshëm të kufirit⁸ dhe dhënies së ndihmës për kalim të kufirit⁹, për një periudhë të caktuar kohore përgjatë viteve 2015-2021.

Qëllimi i këtij Raporti Studimor është analiza e arsytimit të kërkesave të Prokurorisë për gjykimin e veprave penale në fushën e kontrabandimit të migrantëve, si dhe vendimmarrjet e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore (juridiksionit të përgjithshëm) për të evidentuar elementët specifikues e përcaktues të përdorur, por edhe për të nxjerrë në pah vështirësitë e sfidat që hasin përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë penale, në trajtimin e duhur të këtij fenomeni. Në përfundim të këtij raporti, KShH përcjell rekomandime konkrete, të cilat kanë për synim nxitjen e aktorëve përgjegjës, pjesë e sistemit të drejtësisë penale, që të respektojnë dhe të kontribuojnë në zbatimin e kuadrit ligjor ndërkombëtar, duke u referuar në standardet e praktikat më të mira rajonale e evropiane.

Objekt i këtij raporti studimor janë 106 vendimmarrje të Gjykatave të Shkallës së Parë (juridiksionit të përgjithshëm) Sarandë, Korçë, Shkodër, Pogradec dhe Përmet lidhur me gjykimin e dy neneve 297 dhe 298 të Kodit Penal.

Studimi i vendimeve shtrihet në dy plane, atë statistikor, i cili ka synim përfundimin e të dhënave të matshme statistikore lidhur me elementët e ndryshëm që mbartin vendimet konkrete, por gjithashtu konsiston edhe në ofrimin e të dhënave dhe informacioneve cilësore, duke evidentuar dhe përpunuar të dhënat përkatëse mbi mënyrën se si është konstatuar, zhvilluar apo trajtuar nga organet e sistemit të drejtësisë, fenomeni i kontrabandimit të migrantëve.

Studimi synon që, përveç paraqitjes së situatës lidhur me kuptimin dhe zbatimin e drejtë të legjislacionit në këtë drejtim, të adresojë mangësitë e konstatuara duke sugjeruar e propozuar zgjidhje efikente, bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare, me synim përmirësimin e praktikës gjyqësore, si dhe trajtimin e duhur institucional të fenomenit të kontrabandimit të migrantëve.

⁷ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

⁸ Neni 297 Kodi Penal i R.SH

⁹ Neni 298 Kodi Penal i R.SH

2. Metodologjia e Punimit

Në këtë Raport Studimor është trajtuar në rrafshin teorik, por edhe praktik kuptimi dhe elementët e figurave të veprave penale të “Kalimit të paligjshëm të kufirit” dhe “Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit”, parë nga këndvështrimin doktrinal, atë të legjislacionit të brendshëm material dhe procedural penal. Ky dokument zhvillohet mbi një metodologji, e cila zbatohet duke mbajtur në konsideratë aspekte të praktikës gjyqësore të vendit tonë, si një pjesë esenciale e punimit. Dokumenti përmban një analizë të gjetjeve kryesore, të cilat përmbyllen nëpërmjet konkluzioneve e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e situatës në këtë drejtim.

Me qëllim grumbullimin dhe analizimin e të dhënave, gjatë muajit Qershor 2021, KShH ka shkëmbyer korrespondencë zyrtare institucionale me Gjykatat e Shkallës së Parë Pogradec, Përmet, Shkodër, Korçë dhe Sarandë. Për të bërë të mundur një kampionim të saktë në mënyrën e përzgjedhjes së vendimmarrjeve gjyqësore të cilat janë analizuar në punim është mbajtur parasysht në mënyrë racionale kompetenca territoriale e Gjykatave të Shkallës së Parë. Seksionet përbërëse të këtij raporti pasqyrojnë analizën e vendimmarrjeve të gjykatave të cilat në kompetencën e tyre tokësore përfshijnë qytetet që ndodhen pranë pikave kufitare të Qafë-Thanës, Tri Urat, Muriqanit, Kapshticës dhe Konispolit. Nga pikëpamja e shtrirjes në kohë, studimi merr në analizë vendimet e dhëna prej këtyre gjykatave për periudhën kohore 7 vjeçare, prej vitit 2015 deri në vitin 2021.

Në total janë analizuar 106 vendime të vëna në dispozicion të kategorizuara në vendime themeli dhe vendime që lidhen me shqyrtimin e kërkesave të Prokurorive për vlerësimin e masës së sigurimit ‘arrest me burg’ dhe caktimit të masave të tjera të sigurimit, për autorët e dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 297 dhe 298 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Studimi në tërësi përbëhet nga 3 seksione kryesore. **Seksioni i parë** merr në analizë parashikimin ligjor nga legjislacioni ynë për kryerjen e veprave penale që lidhen me kalimin e paligjshëm të kufirit dhe ndërlidhjen me to të figurave të tjera të veprave penale, duke analizuar të gjithë elementët e tyre. Ndërsa **seksioni i dytë** përqëndrohet tek qasja që kanë Prokuroritë dhe Gjykatat (vendimet e të cilave janë studiuar) kundrejt këtyre rasteve. Në **seksionin e tretë** janë pasqyruar gjetjet më të rëndësishme të këtij raporti studimor, si dhe rekomandimet drejtuar gjykatave të rretheve gjyqësore, pjesë e juridiksionit të zakonshëm.

Duke mbajtur në konsideratë, rëndësinë që ka garantimi i aksesit të pakufizuar dhe objektiv në të dhënat e disponuara nga 5 Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, gjejmë rastin të falenderojmë Kryetarët dhe stafet e administratës gjyqësore të këtyre gjykatave që kanë vënë në dispozicion vendimmarrjet që janë objekt studimi i këtij raporti studimor të KShH-së.

Përmbledhje Ekzekutive

Për realizimin e këtij studimi, në rrugë zyrtare nga ana e KShH-së¹⁰ janë analizuar 106 vendime gjyqësore të dhëna nga 5 gjykatat e shkallës së parë Pogradec, Përmet, Shkodër, Korçë dhe Sarandë. Përzgjedhja e këtyre Gjykatave, vendimet e të cilave do të analizoheshin, është bërë duke mbajtur parasysh kompetencën e tyre territoriale, me synimin për të përfshirë rrugët e kalimit tranzit të migrantëve në vendin tonë. Gjithashtu në përzgjedhjen e vendimmarrjeve, KShH ka mbajtur në konsideratë edhe shpërndarjen e pikave të kalimit kufitar, por edhe dinamikën e rrugëve të përdorura nga migrantët, nëpërmjet përdorimit të paligjshëm të kufirit të gjelbër, për të shkuar drejt destinacioneve evropiane.

Vendimet e analizuarra i përkasin periudhës kohore 7 vjeçare, 2015 – 2021, për 2 figura të veprave penale, konkretisht, “Kalimi i paligjshëm i kufirit” parashikuar nga neni 297 i K.P dhe “Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufijve” parashikuar nga neni 298 i K.P.

Në pjesën më të madhe të vendimmarrjeve, ekspertët e angazhuar nuk kanë konstatuar konkurrueshmëri të këtyre veprave penale. Përfundimisht, në 5 raste, të pandehurit janë akuzuar edhe për vepra të tjera penale të tilla si, “Falsifikimi i dokumenteve” parashikuar nga neni 186 i K.P, “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i K.P, “Mosbindja ndaj urdhrorit të punonjësit të policisë së rendit publik” parashikuar nga neni 242 i K.P, ose “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” parashikuar nga neni 189 i K.P.

Nisur nga vendimmarrjet e analizuarra rezulton se migrantët e huaj, që janë marrë në pyetje për efekt të procesit hetimor rezulton se kanë dhënë informacion, i cili pasi është analizuar reflekton se pjesa më e madhe e tyre deklarojnë se vijnë nga Siria, ndjekur nga shtetas maroken, afgan, palestinezë dhe irakian. Migrantët detyrohen të largohen nga vendet e tyre për shkak të situatës së luftës me të cilën përballen shtetete tyre të origjinës. Ata largohen të organizuar në grupe që përbëhen nga 2 ose më shumë familje, si dhe në grupe me individë që i njohin ose për shkak të qëllimit të përbashkët për t’u larguar e kanë përshtuar së bashku itinerarin e udhëtimit.

Sa i përket itinerarit të ndjekur deri në mbërritjen në territorin shqiptar, vihet re konsolidimi i rrugëve të kalimit të cilat përdoren nga emigrantët. Fillimisht ata shkojnë në shtetin turk dhe më pas kalojnë kufirin me shtetin grek dhe në vazhdim drejtohen për në juglindje të vendit tonë si vendkalimi i rradhës. Këto shtete përgjithësisht shërbejnë si vende tranziti dhe emigrantët në asnjë rast nuk kanë reflektuar qëllimin e tyre për të qëndruar në këto vende tranziti, por destinacioni i tyre mbeten vendet evropiane. Por janë evidentuar edhe raste ku qëndrimi i emigrantëve në vende të ndryshme ka qenë më i zgjatur në kohë, duke mos shërbyer thjeshtë si një rrugë e shpejtë dhe e përkohshme tranziti.

Vërehen 3 forma të ndërveprimit të tyre me kontrabanduesit që i ndihmojnë për të kaluar kufirin dhe territorin shqiptar: 1. Takimi me kontrabanduesit, pranë pikave të kalimit kufitar, ndërkohë që me ndihmën e këtyre të fundit mundësohet përfshirja e refugjatëve në grupe të tjera më të mëdha, të cilat kanë si qëllim të përbashkët të njëjtin destinacion. 2. Identifikimi nga vetë migrantët i kontrabanduesve, ose ndihmohen nga ana e personave të tjerë që ndodhen në shtetet fqinje, të cilët

¹⁰ Shkresë Nr.442, datë 25.06.2021 “Kërkesë për informacion”-Shkresë Nr.463, datë 14.07.2021 “Kthim Përgjigje” Shkresë Nr.441, datë 25.06.2021 “Kërkesë për informacion”-Shkresë Nr.461, datë 13.07.2021 “Kthim Përgjigje” Shkresë Nr.438, datë 25.06.2021 “Kërkesë për informacion”-Shkresë Nr.464, datë 14.07.2021 “Kthim Përgjigje”

më herët kanë përdorur të njëjtën mënyrë për të kaluar në mënyrë të paligjshme në një tjetër territor shtetëror; 3. Komunikimi në rrjetet sociale dhe app me kontrabanduesit, të cilët i ndihmojnë nëpërmjet njohjes me persona të caktuar ose nëpërmjet ndihmës që ju ofrohet për transport me taksi.

Nga përpunimi i vendimeve gjyqësore rezulton se shumtë që i jepen kontrabanduesve variojnë nga 100 deri në 500 euro, në varësi të ndihmës dhe itinerarit që ata përshkrojnë në territor, në saj të angazhimit të kontrabanduesve. Ndërkohë rezulton se shtetasit e huaj të cilët kalojnë tranzit në vendin tonë, e kanë të pamundur të aksesojnë shërbimet e transportit publik ndërqytetas. Arsytet lidhen me refuzimin e ofruesve të shërbimeve të transportit rrugor për t'i transportuar, për shkak të rasteve të ngjashme të cilat janë goditur nga agjencitë ligjzbatuese, ndërkohë që ofruesit e këtyre shërbimeve në disa raste janë proceduar penalisht si autorë të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”. Kur marrëveshja midis emigrantëve dhe personave të cilët do t'i transportojnë është bërë me qëllim që të interesuarit të arrijnë në destinacionin përfundimtar, pra në shtetin ku synojnë të vendosen përfundimisht, emigrantët përcillen dhe priten në kufijtë e çdo shteti nga persona me të cilët kanë komunikime të vazhdueshme deri sa mbërrijnë në vendin e synuar. Në këto raste ndihma u jepet nga grupe të mirëstrukturuara kriminale por pavarësisht nga kjo, këto çështje nuk janë hetuar nga prokuroria e krimeve të rënda apo SPAK (pas krijimit të tij) dhe rrjedhimisht nuk janë gjykuar nga GJKKO. Në këto raste, i gjithë ky proces i kontrabandimit të migrantëve rezulton të karakterizohet nga një shkallë e lartë koordinimi, ndërkohë për dërgimin deri në destinacionin final rezulton të jenë paguar deri në 9000 euro për person¹¹.

Në aspektin statistikor vërehet se në vendimmarrjet e studiuara mbizotëron hetimi dhe gjykimi për veprën penale “Kalim i paligjshëm i kufirit” parashikuar nga neni 297 i K.P., e përfaqësuar me 86 vendime gjithsej, ku rreth 88 % e tyre janë dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë. Edhe pse me numrin më të lartë të vendimmarrjeve (rreth 72% e totalit të vendimeve të studiuara), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë reflekton marzhin më të ulët të vendimeve për çështjet e gjykuara, për veprën penale të ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit, e njohur si kontrabandimi i migrantëve, në raport me gjykatat e tjera që kanë një numër vendimesh disa fish më të ulët se ajo. Kjo e dhënë statistikore, në vlerësimin e KShH-së, ngre dyshime të arsyeshme për veprimtarinë e organit të prokurorisë në hetimin efektiv të nenit 298 të Kodit Penal.

Në lidhje me anën objektive të kryerjes së veprës penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” e parashikuar nga neni 298 i K.P., forma më e shpeshtë e konstatuar e konsumimit të saj është ajo e transportimit të personave. Nga analiza e vendimeve të gjykatës rezulton se vetëm në 1 rast, autorët fillimisht i strehonin refugjatët dhe më pas kryenin transportin e tyre, duke dëshmuar kështu një formë më të sofistikuar të aktivitetit kriminal, krahasuar me rastet e tjera të marra në studim me anë të këtyre vendimeve.

Në shumicën dërrmuese të vendimmarrjeve të studiuara, nuk rezulton që konsumimi i figurës së veprës penale të jetë shoqëruar me pasoja të rënda, si dëmtim i shëndetit apo humbje e jetës etj. Vetëm në 1 vendimmarrje është konstatuar ekzistenca e pasojave të rënda në humbjen e jetës së 5 viktimave, midis të cilave 1 femër dhe 1 foshnjë disa muajshe.

¹¹ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Vendimi 41-2021-430,1284 datë 08.04.2021

Ndër vendimet e studiuara, rezulton se Gjykatat e Shkallëve të Para kanë dalë me 95 vendime në lidhje me fajësinë dhe dënimin e të pandehurve. Vetëm në një vendim gjykata ka shpallur pafajësinë e të pandehurit. Ndërkohë në 10 raste, Gjykata ka marrë në shqyrtim kërkesën e Prokurorit për caktimin e masës së sigurimit ndaj të pandehurve. Në 77 raste është aplikuar dënimi me gjobë dhe në 18 raste dënimi kryesor me burgim, por në 3 prej këtyre të fundit Gjykata në shqyrtim të rrethanave faktike ka vendosur pezullimin e dënimit me burgim dhe vënie në provë të dënuarve. Në 95% të rasteve si autorë të dyshuar të veprave penale rezultojnë meshkujt, por ka edhe vendimmarrje që evidentojnë vajza dhe gra të përfshira.

Vepra penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit" në rreth 63% të rasteve (pra 12 raste nga 19 vendime të analizuara) është argumentuar se është kryer në bashkëpunim, por hetimi nuk rezulton të ketë hedhur dritë mbi veprimtari të strukturuar kriminale të kontrabandimit të migrantëve, çka do të sillte hetimin dhe gjykimin e këtyre veprave penale nga organet e specializuara të drejtësisë, si prokuroritë dhe gjykatat e krimeve të rënda të kohës apo SPAK dhe Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me ngritjen e saj përgjatë periudhës objekt studimi. Të dhënat në rajon, BE dhe kontrabandën e migrantëve shqiptarë në Mbretërinë e Bashkuar hedhin dritë mbi faktin se bashkëpunimi për këtë vepër nuk është vetëm i rangut kombëtar por edhe ndërkombëtar, duke krijuar një rrjet të sofistikuar për krijimin e kushteve të përshtatshme për krijimin e një rruge më të lehtësuar për kalimin e emigrantëve, në mënyrë të paligjshme, në territoret e disa shteteve. Por pavarësisht nga kjo, të dhënat e rasteve objekt studimi nxjerrin në pah se ky bashkëpunim nuk hetohet si formë e sofistikuar nga organet e specializuara të drejtësisë, por si formë e thjeshtë nga gjykatat me juridiksion të përgjithshëm duke goditur me qasjen e "majës së ajsbergut" fenomenin e duke lehtësuar dënueshmërinë e të pandehurve të deklaruar fajtorë.

Gjykatat në zgjidhjen e çështjeve të analizuara kanë përdorur të dy llojet e gjykimeve si gjykimin e zakonshëm edhe atë të shkurtuar. Në rreth 24.5% të rasteve (ose 26 raste) është aplikuar gjykimi i shkurtuar. Lloji më i përdorur i dënimit është ai me gjobë në rreth 73% të rasteve, i ndjekur nga dënimi me burg në rreth 17% të rasteve, ndërkohë që në një numër më të ulët konsiderohet aplikimi i dënimeve alternative të dënimit me burg në 3% të rasteve. Konkretisht, në 3 nga 18 rastet e dënimit me burg janë zbatuar dënime alternative të burgimit si:

- detyrim për kryerjen e një pune në interes publik¹²
- vënia në provë me kusht¹³

Nga përpunimi statistikor dhe cilësor i vendimeve gjyqësore kampion i këtij studimi, nga totali i personave të gjykuar, rezulton se 75 persona klasifikohen nën gjendjen gjyqësore "të padënuar më parë" dhe 31 persona rezultojnë me gjendje gjyqësore "i/e dënuar më parë". Këto statistika fundore tregojnë se totali i personave të dënuar më parë dhe që shfaqen si përsëritës në krim/recidivistë, përbën rreth 29% të numrit total të personave të cilët konsumojnë këto vepra penale për herë të parë.

Në analizë të 106 vendimeve të përpunuara në kuadër të këtij studimi rezulton se dënimi me gjobë është aplikuar në 77 raste, nga të cilat 18 shtetas janë pozicionuar nën statusin procedural i/e

¹² Vendimi i Gjykatës së Përmetit, Nr. 22-2018-62, datë 22.02.2018

¹³ Vendime të Gjykatës së Pogradecit, Nr. (449)----- 67, datë 29.04.2021 dhe Nr. (650)---121, datë 09.06.2021

pandehur gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndërkohë që 59 shtetas rezultojnë i/e dënuar. Dënimi me gjobë është aplikuar vetëm për të pandehurit e akuzuar për veprën penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, të parashikuar në nenin 297 të Kodit Penal. Gjoha më e lartë e dhënë nga gjykata është 150.000 lekë dhe gjoha më e ulët është 40.000 lekë. Dënimi me gjobë afër kufirit minimal në shumën 60.000 lekë është aplikuar në 37 raste dhe përbën masën e dënimit me gjobë të dhënë më shpesh nga gjykata.

Shtetasit e huaj që kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme në 95% të rasteve janë shtetas nga vende si Siria, Afganistani dhe Palestina, të cilët zgjedhin të largohen nga vendet e tyre të origjinës për shkak të luftërave dhe konflikteve civile, të cilat kanë përmbysur dhe destabilizuar demokracinë në ato shtete. Nga të dhënat e vendimmarrjeve të studiuara rezulton se këta shtetas të ardhur nga vendet e treta kanë marrë pjesë në procesin gjyqësor penal si persona në cilësinë e dëshmitarit. Në pjesën dërrmuese, procesi gjyqësor penal është zhvilluar ndaj të pandehurve me shtetësi shqiptare, të akuzuar si ndihmues për kalimin e kufirit në mënyrë të paligjshme, ndërkohë ndaj shtetasve të huaj vetëm në një rast, Gjykata ka caktuar dënimin me burgim, nën këtë cilësim ligjor. Si dhe në një rast tjetër, ndaj një shtetasi të huaj azilkërkues, Gjykata ka caktuar masën e sigurimit arrest në burg nën akuzën “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” të kryer në bashkëpunim sipas nenit 298/3 të K.P.

Nga analiza individuale dhe krahasimore e pjesës arsyetuese të vendimeve objekt i këtij studimi, rezulton se në mjaft raste mungon arsyetimi i plotë, i qartë dhe logjik. Në pjesën më të madhe të vendimeve vërehen arsyetime formale dhe standarte, pa u fokusuar tek çështja konkrete, ndërkohë që më së shumti ndryshojnë gjeneralitetet e palëve ndërgjyqëse dhe periudhat kohore, duke reflektuar një gjuhë të përgjithshme të ngjashme dhe uniforme. Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë, përfundimisht, qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim¹⁴. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik¹⁵.

Për veprën penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit” parashikuar nga neni 297 i K.P, nga përpunimi i 106 vendimeve rezulton se 27 shtetas janë gjykuar në cilësinë e të pandehurit. Për rreth 66% të tyre (ose 18 të pandehur), Gjykata ka caktuar në shumicën dërrmuese ndaj të dënuarve që janë deklaruar fajtor, dënimin me gjobë dhe në 2 raste janë caktuar dënime alternative të dënimit me burgim. Për 4 rastet e tjera, Gjykata rezulton të ketë caktuar dënimin me burgim. Ndërkohë, rasti i mbetur i përket kërkesës për caktim masë sigurimi nga ana e Gjykatës, e cila nuk ka një vendimmarrje konkrete dënimi. Edhe pse në shifra të ulëta, maksimumi i dënimit me burg të dhënë

¹⁴ Shih vendimet nr.8, datë 16.03.2011; nr.23, datë 04.11.2008; nr.11, datë 02.04.2008; nr.7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese

¹⁵ shih vendimet nr.3, datë 19.02.2013; nr.20, datë 13.04.2012; nr 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese

është 2 vite burgim (pas aplikimit të gjykimit të shkurtuar) dhe minimumi i dhënë është 10 ditë burg.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i K.P. “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” rezulton se ndaj 30 të pandehurve, Gjykata ka vendosur t’i deklarojë fajtorë duke dhënë dënimin me burg për 57% të tyre ose 17 prej të pandehurve. Marzhi maksimal i dënimit me burg ndaj tyre është 10 vjet dhe 6 muaj sipas paragrafit 4) të dispozitës së sipërcituar. Për asnjë nga të pandehurit nuk rezulton që Prokuroria të ketë kërkuar caktimin e dënimit me gjobë, si rrjedhojë as Gjykata nuk ka disponuar me vendimmarrje të kësaj natyre.

SEKSIONI I

“DINAMIKAT E DY FENOMENEVE TË NDRYSHME KRIMINALE” ‘Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror’ dhe ‘Ndhima për kalim të paligjshëm të kufijve’

1.1 Figurat e veprave penale të konsumuara nga të pandehurit

Vendimet e marra në analizë dhe të trajtuara në këtë punim, janë kampionuar nga 5 gjykata të shkallës së parë dhe konkretisht gjykatat e Pogradecit, Përmetit, Shkodrës, Korçës dhe Sarandës. Në vendimet e analizuara këto gjykata kanë gjykuar çështje, në të cilat të pandehurit e kanë kaluar kufirin shtetëror në mënyrë të fshehtë, pa u paraqitur në pikat e kontrollit kufitar dhe pa paraqitur dokumentacionin përkatës si pasaportë apo leje qëndrimi, si dhe raste kur janë kapur në flagrancë duke ndihmuar shtetasit, për të kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme. Bazuar në rrethanat e çështjeve në fjalë është konkluduar nga gjykata se me veprimet e tyre, personat e përfshirë në sjellje të tilla kanë konsumuar të gjithë elementët për t’u kualifikuar sipas figurave të veprave penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit” dhe “Ndhima për kalim të paligjshëm të kufirit” parashikuar nga nenet 297 dhe 298 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Nga analiza sasiore e 106 vendimeve të 5 gjykatave rezulton se ato janë dhënë në harkun kohor 7 vjeçar që i korrespondon periudhës 2015 – 2021, të kategorizuara sipas veprës penale të konsumuar si më poshtë:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka dhënë gjithsej 11 vendime, prej të cilave 4 janë kualifikuar në bazë të nenit 297 të K.P dhe 7 në bazë të nenit 298 të K.P
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet ka dhënë gjithsej 6 vendime, prej të cilave 5 janë kualifikuar në bazë të nenit 297 të K.P dhe 1 në bazë të nenit 298 të K.P
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka dhënë gjithsej 6 vendime, prej të cilave 3 janë kualifikuar në bazë të nenit 297 të K.P dhe 2 në bazë të nenit 298 të K.P, ndërkohë që në 1 prej rasteve nuk është provuar kryerja e veprës penale, e si rrjedhojë Gjykata ka disponuar nëpërmjet vendimit të pafajësisë së shtetasit të pandehur
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka dhënë gjithsej 12 vendime, prej të cilave 4 janë kualifikuar në bazë të nenit 297 të K.P dhe 8 në bazë të nenit 298 të K.P
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka dhënë gjithsej 71 vendime, prej të cilave 70 janë kualifikuar në bazë të nenit 297 të K.P dhe 1 në bazë të nenit 298 të K.P.

Neni (K.Penal)	Pogradec	Përmet	Shkodër	Korcë	Sarandë
297	4	5	3	4	70
298	7	1	2	8	1
Nuk provohet			1 (Pafajësi)		




Tabela 1.

Nisur nga analiza statistikore e vendimmarrjeve të studiuara, rezulton se numri më i madh i tyre i korrespondon veprës penale "Kalimi i paligjshëm i kufirit" parashikuar nga neni 297 i K.P, me 86 vendime gjithsej. Nga totali i tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë e cila zë pjesën dërrmuese të vendimeve të dhëna për këtë veprë penale, konkretisht 70 vendime të dhëna.

Shumica e rasteve të kalimit të paligjshëm të kufirit, i referohen situatës së shtetasve shqiptarë që emigrojnë drejt shtetit grek për arsye ekonomike.

Sa i përket vendimeve të dhëna për veprën penale "Ndhima për kalim të paligjshëm të kufirit", parashikuar nga neni 298 të K.P, Gjykatat kanë disponuar nëpërmjet 19 vendimeve, nga të cilat rezulton se numri më i madh i tyre janë dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë në 8 raste, ndjekur nga ajo e Pogradecit me 7 vendime. Dinamika e shtuar e kryerjes së kësaj veprë penale vetëm në këto dy qarqe i referohet kryesisht situatës së krijuar nga flukset emigratore të refugjatëve të ardhur nga vende të përfshira në konflikte të armatosura, të tilla si Siria, Afganistani dhe Palestina. Këta shtetas mbërrijnë në juglindje të vendit tonë, pasi kalojnë kufirin turk dhe atë grek. Edhe pse me numrin më të lartë të vendimmarrjeve (70% e totalit të vendimeve të studiuara), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë reflekton marzhin më të ulët të vendimeve për veprën penale të ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit, e njohur si kontrabandimi i migrantëve, në raport me gjykatat e tjera që kanë një numër vendimesh disa fish më të ulët se ajo. Kjo e dhënë statistikore, ngre dyshime të arsyeshme për veprimtarinë e prokurorisë në hetimin efektiv të nenit 298 të Kodit Penal.

1.1.1 Elementët e përbashkët dhe dallimet ndërmjet këtyre dy figurave të veprave penale

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë inkriminon në kuadër të kreut VIII të tij, të titulluar 'Krimet kundër Autoritetit të Shtetit', seksioni IV 'vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetëror', kundërvajtjen penale "Kalimi i paligjshëm i kufirit".

Sipas nenit 297 KP: "Kalimi i paligjshëm i kufijve shtetërorë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet".

Dispozita pasardhëse parashikon një tjetër vepër të ngjashme me të në disa prej elementëve substancialë, "ndihmën për kalim të paligjshëm të kufirit". Pavarësisht se kjo vepër nuk titullohet kontrabandë e migrantëve, siç njihet ndryshe ky fenomen anembanë botës, dispozita e Kodit tonë Penal ka në përbërje elementë që e identifikojnë me të. Konkretisht, neni 298 KP përcakton se:

“Strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit ose i mjeteve të tjera të transportit apo çdo ndihmë tjetër, me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit të Republikës së Shqipërisë ose për hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet tjetër, pa qenë shtetas i tij ose që nuk ka leje qëndrimi në atë shtet, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.”

“Kur ndihma jepet për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.”

“Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”

“Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.”

“Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me ¼ e dënimit të dhënë.”

Nëse do t'i referoheshim dispozitave të mësipërme, të dyja figurat e veprave penale paraqesin specifika të ndryshme krahas klasifikimit të tyre si kundërvajte penale dhe krime. Ndaj shohim të arsyeshme që në një mënyrë të sintetizuar, të përmendim specifikat e këtyre dy veprave penale.

Fakti se ligjvënësi ka parashikuar kategorizimin e tyre në një seksion të vetëm të legjislacionit penal material nënkupton se objekti i cënuar në të dyja figurat e veprave penale mbetet i njëjtë, e konsiston në respektimin e rregullave që sigurojnë paprekshmërinë territoriale të shtetit. Element tjetër i përbashkët ka të bëjë me autorin, cilësimi i të cilit nuk lidhet me ndonjë veçori të posaçme, për shkak të funksionit apo detyrës apo me një shtetësi të caktuar. Potencialisht, subjekt aktiv i këtyre veprave penale mund të jenë shtetasit shqiptarë, të huaj dhe ata pa shtetësi, nëse përmbushin kriteret për përgjegjësinë penale. Përrjashtim nga ky rregull konsiderohet në figurën e veprës penale të “ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve”, e cila në paragrafin e saj të fundit parashikon konsumimin e saj nga subjekti i posaçëm, i cili “shfrytëzon funksionin shtetëror ose shërbimin publik”.

Veçori thelbësore që i dallon këto vepra në kuptim të autorit, është se në rastin e kalimit të paligjshëm të kufirit, autor i veprës është vetë personi që kalon në mënyrë të paligjshme kufirin, ndërkohë që në ndihmën për kalimin e paligjshëm të kufirit, autori është personi që ndihmon një shtetas të kalojë në mënyrë të paligjshme të kufirit.

Sa i përket elementit të fajësisë, në aspektin subjektiv në të dyja rastet vepra konsumohet me dashje direkte dhe nuk kërkohet konstatimi i ndonjë motivi të posaçëm, nga ana e autorit në momentin e kryerjes së veprës penale. Në rastin e konsumimit të veprës penale të “ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve” parashikuar nga neni 298 KP, në rrethanat e cilësuar të paragrafit të dytë të dispozitës, del si një element i posaçëm i kualifikimit edhe qëllimi posaçëm i autorit, i cili në këtë rast lidhet me përfitimin material.

Element thelbësor dallues midis këtyre dy figurave të veprave penale është edhe ana objektive, ose e thënë ndryshe, mënyra e kryerjes apo tërësia e veprimeve të konsumuara nga autori, të nevojshme për kualifikimin sipas kësaj vepre penale. Kështu në rastin e nenit 297 KP “Kalimi i paligjshëm i

kufirit” si forma të kryerjes së veprës kemi hyrjen dhe daljen nga territori i vendit jo nëpërmjet pikave të caktuara të kontrollit doganor, por me mënyra të tjera të jashtëligjshme. Ndërsa në nenin 298 KP “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit” janë të parashikuara një sërë veprimesh si strehim, shoqërim, transportim e forma të tjera ndihme që i jepen personave që kalojnë kufirin për në shtetin tjetër, e që nuk janë të pajisur me leje qëndrimi. Në analizë të elementëve të anës objektive të këtyre dy figurave të veprës penale na rezulton se në rastin e nenin 298 KP “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, tërësia e elementëve të anës objektive të kësaj figure të veprës penale mbart një shkallë më të lartë përgatitje, kërkon më tepër angazhim nga autorët dhe ka prirje të jetë një veprimtari më e sofistikuar, krahasuar me *modus operandi (mënyrën e veprimit)* që autori përdor në rastin e kalimit të paligjshëm të kufirit.

Një dallim tjetër i rëndësishëm midis këtyre dy figurave të veprave penale është dhe momenti i përcaktimit se kur vepra do të quhet e kryer. Për të konsideruar të kryer veprën penale të kalimit të kufirit kërkohet që vepra të kryhet plotësisht, pra personi të ketë dalë/hyrë nga territori i shtetit shqiptar. Në qoftë se vepra mbetet në tentativë, vepra do të cilësohet sipas nenit 297 në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal¹⁶. Ndërsa në rastin e veprës ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, krimi do të quhet i kryer me strehimin, shoqërimin, vënien në dispozicion ose përdorimin e mjeteve të transportit për të ndihmuar në kalimin e paligjshëm, pavarësisht nëse ka ardhur ose jo pasojë tjetër dmth, pavarësisht nëse personi arrin apo jo të hyjë/kalojë në territorin e shtetit tjetër destinacion.

Neni 298 KP “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit” parashikon si rrethana të cilësuar edhe pasoja të caktuara apo elementë të tjerë si: “bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo ka sjellë pasoja të rënda” por edhe “kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit”. Rrethana të tilla nuk konstatohen në rastin e veprës penale të parashikuar nga neni 297 KP, pasi autor i saj është vetë personi që kalon në mënyrë të paligjshme kufirin.

1.1.2 Ndërlidhja me veprat e tjera penale

Kalimi i kufirit në mënyrë të paligjshme, si një mjet për realizimin e kontrabandës së migrantëve, për të arritur qëllimin kërkon dhe një situatë të favorshme lidhur me krijimin e infrastrukturës së përshtatshme kriminale kryesisht sigurimin e mjeteve apo aplikimin e mekanizmave me anën e të cilave të bëhet e realizueshme vepra. Në këtë kuptim, në raste sporadike, autorët kanë kryer edhe vepra të tjera penale krahas atyre të parashikuara nga nenet 297 dhe 298 i K.P, si një etapë për të bërë të mundur realizimin e qëllimit të tyre, kontrabandimin e migrantëve.

Kalim të paligjshëm të kufirit do të kemi edhe në rastet kur hyrja e parregullt në territorin shqiptar, bëhet duke përdorur vizë, pasaportë apo leje qëndrimi të falsifikuar. Neni 189 K.P parashikon se: “Falsifikimi ose përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave apo i vizave të falsifikuara, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.” Në këtë rast kemi konkurim të veprave (nenit 189 dhe 297 të Kodit Penal) dhe personi përgjigjet për dy vepra penale, atë të kalimit të paligjshëm dhe të falsifikimit të dokumentave.

Ky fakt është konstatuar edhe në një vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë ku nga rrethanat e faktit ka rezultuar se i pandehuri shtetas turk kishte kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme duke u fshehur në një dollap i mbuluar me batanije, në dhomën në pjesën e poshtme të një jahti të emërtuar “Rest” në portin e Sarandës. Në momentin që policia shqiptare e ka konstatuar

¹⁶ E drejta Penale-Pjesa e Posaçme. Prof.Dr.Ismet Elezi

gjatë një kontrolli, ai ka treguar një mjet identifikimi dhe një leje drejtimi të falsifikuar.¹⁷ Në vendimin e saj gjykata e ka dënuar shtetasin turk për kryerjen e dy veprave penale në bazë të neneve 297 dhe 189/1 të Kodit Penal.

Në një rast tjetër, Gjykata e Shkallës së Parë Pogradec ka dënuar autorin krahas veprës “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit” edhe për veprat “Falsifikim i dokumentave” dhe “Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt” në bazë të neneve 186/1¹⁸ dhe 291¹⁹ të Kodit Penal. Nga rrethanat e faktit të verifikuara nga Gjykata e Pogradecit rezulton se i pandehuri ka ndihmuar 6 shtetas të huaj sirian për të kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme, nëpërmjet bashkëpunimit me shtetas të tjerë të pidentifikuar, duke i transportuar me automjetin privat. I pandehuri nuk ka qenë i pajisur me leje drejtimi dhe leja e sekuestruar ka qenë tërësisht e fallsifikuar gjë për të cilën gjatë marrjes në pyetje ai është shprehur se nuk kishte pasur dijeni²⁰.

Rasti i tretë në të cilin gjykata ka konstatuar elementë të më shumë sesa një veprë penale, ka të bëjë me një rast të gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Korçë. Sipas pjesës përshkuese të vendimit, rezulton se autori i vepës në momentin që patrulla e policisë i ka bërë me shenjë të ndalonte, për shkak se me mjetin e tij ishte duke transportuar 4 shtetas palestinezë që po i ndihmonte për të kaluar tranzit kundrejt pagesës, nuk ka ndaluar por është larguar me shpejtësi në një drejtim tjetër (të Lozhanit).²¹ Bazuar në veprimet e tij, gjykata e ka dënuar krahas nenit 298 të KP edhe për nenin 242 të KP.²²

1.1.3 Ana objektive

Ana objektive si një element i domosdoshëm i veprës, përbëhet nga tërësia e të gjitha veprimeve apo mosveprimeve të kundërligjshme që ndërmerr autori i veprës penale për arritjen e qëllimit kriminal, duke përfshirë tërësinë e rrethanave që lidhen me kryerjen e veprës penale të tilla si vendi apo mjetet e përdorura.

Kalimi i paligjshëm i kufirit

Në analizë të vendimeve gjyqësore të dhëna për kryerjen e kundravajtjes penale “Kalim i paligjshëm i kufirit” vërehet se forma dhe mjetet e përdorura nga autorët e veprës penale janë pothuajse të njëjta. Rastet mbizotëruese janë ato të daljes prej kufirit shqiptar për të shkuar në vendet fqinë për arsye punësimi. Kështu rezulton se të pandehurit nisen nga qyteti/fshati i tyre i banimit drejt pikave të kalimit kufitar me mjete të rastit dhe kalojnë në shtetin fqinj në këmbë, nëpërmjet kufirit të gjelbër. Zakonisht ata e kalojnë të vetëm, kjo për shkak se në shumicën e rasteve rezulton se kanë shkuar edhe herë të tjera, por ka raste kur janë të shoqëruar në grup. Ata udhëtojnë për orë të tëra deri sa arrijnë në fshatin/qytetin më të afërt të vendit fqinj, dhe fillojnë të kërkojnë për punë aty ose largohen me autobuza drejt qyteteve të tjera. Rezulton se më të shpeshta janë

¹⁷ Vendimi 23-2019-1762, datë 09.10.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

¹⁸ Neni 186/1 *Falsifikimi i dokumenteve Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet.*

¹⁹ Neni 291 *Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet. Gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.*

²⁰ Vendimi 43-2021-499, datë 07.15.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

²¹ Vendimi 41-2021-945, datë 12.03.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë

²² Mosbindja ndaj urdhrave të ligjshme të punonjësit të policisë së rendit publik përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

rastet kur ata janë konstatuar nga Policia e shtetit fqinj pa dokumenta kur kanë qenë duke udhëtuar ose punuar, por nuk mungojnë as rastet kur janë kapur duke u rikthyer²³ në Shqipëri dhe kjo për shkak se nuk kanë arritur të gjejnë punë të qëndrueshme.

Vërehet se destinacioni përfundimtar nuk është gjithmonë shteti fqinj, në disa raste, me mbërritjen në Greqi (vend i BE-së), ata janë larguar me mjete të tilla si traget, avion, kamion drejt shteteve të tjera si Belgjika, Anglia, Spanja dhe Italia. Ata munden t'i kalojnë kufijtë e vendeve të tjera me anë të dokumentave të falsifikuara, që i sigurojnë kundrejt shpërblimeve ndaj personave të panjohur prej tyre²⁴. Siç u përmend edhe më sipër, përgjithësisht rruga e kalimit është kufiri tokësor, nëpërmjet të cilit personat kalojnë në shtetin tjetër. Vetëm në një rast personat kanë përdorur kufirin detar për të shkuar në shtetin grek, nëpërmjet dyshekëve të detit, dhe janë konstatuar nga policia për faktin se rryma detare nuk i lejonte të vazhdonin rrugën.²⁵

Nga një vështrim i përgjithshëm mbi rrethanat e kryerjes së kësaj vepre rezulton se:

- **Së pari**, në të gjitha rastet, të pandehurit janë konstatuar në mungesë të dokumentave apo lejeve të qëndrimit (nuk kanë munguar rastet kur kanë pretenduar se e kanë humbur apo në pikat e kontrollit doganor nuk jua kanë pranuar).
- **Së dyti**, në numrin më të madh të rasteve, hera e fundit kur i pandehuri kishte një dalje të ligjshme nga territori shqiptar përkonte me periudha të largëta kohore, deri në 2 vite më parë. Ndërkohë, ka raste në të cilat personi kishte dalje nga një shtet, por ndërkohë nuk i korrespondonin hyrjet. Kështu në një rast personi rezultonte se kishte dalë vetëm një herë ligjërisht nga Shqipëria dhe ndërkohë është kthyer 2 herë nga shteti grek²⁶. Mungesa e korrespondencës midis hyrjeve dhe daljeve hedh dritë për kalimin e paligjshëm të këtyre shtetasve në kufirin midis Shqipërisë dhe Greqisë.
- **Së treti**, rezulton se në pjesën më të madhe të rasteve, arsyet e parashtruara përpara gjykatës, prej shtetasve, të cilët shkelin në mënyrë të paligjshme kufirin, lidhen me arsyet ekonomike, konkretisht nevojën për punësim në vendin fqinj.
- **Së fundmi**, në shumicën dërrmuese të rasteve, shtetasit të cilët shkelin në mënyrë të paligjshme kufirin, janë përsëritës të këtij veprimi, ku edhe kanë marrë masa administrative nga shteti ynë ose ekspuls apo *apellas/deportim* nga shtetet e tjera²⁷.

“Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufirit”

Sa i përket figurës së veprës penale “Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufirit” parashikuar nga neni 298 i K.P, nga analiza e vendimeve gjyqësore të marra në shqyrtim rezulton se më së shumti, ajo konsumohet nëpërmjet formave të “transportit” ose nëpërmjet “strehimit”. Ndhimja që u jepet migrantëve, nëpërmjet sigurimit të transportit nga autorët e kësaj vepre penale shfaq disa specifika. Kryesisht, ndihma është ofruar nëpërmjet vënies në dispozicion të mjeteve të transportit (automjeteve). Këto mjete rezulton se në rastet më të shumta janë marrë me qera ditore ose javore, në raste të tjera janë në pronësi të autorëve ose personave të afërm. Duke parë gjithë rrethanat se si organizohet nga autorët e veprave penale, dhënia e ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, rezulton se marrja e mjetit me qera bëhet për dy arsye kryesore. *Së pari*, kjo lidhet me pamundësinë

²³ Shënim, këto raste evidentohen vetëm në vendimet e Gjykatës së Sarandës.

²⁴ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, Vendimi 41-2021-1294, datë 09.04.2021

²⁵ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendimi 23-2016-1094, datë 31.05.2016

²⁶ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendimi 23-2016-1332, datë 01.07.2016

²⁷ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendimi 23-2020-878, datë 17.05.2020.

ekonomike të autorëve të veprës penale për të financuar në shuma të konsiderueshme aktivitetin e tyre kriminal, konkretisht pamundësia për të blerë një mjet, dhe *së dyti* marrja me qera bëhet, në kuadër të strategjisë së tyre kriminale, për t'ju shmangur apo për të mos rënë në sy të patrullave të policisë. Kështu, në një rast personi kishte marrë 3 makina me qera në emrin e vet dhe me ndihmën e 2 personave të tjerë do transportonin disa shtetas që priteshin të mbërrinin në kufirin juglindor të vendit tonë.²⁸

Kontakti ndërmjet autorëve të veprës penale dhe refugjatëve rezulton se bëhet në 3 mënyra kryesore:

- Komunikojnë nëpërmjet rrjeteve sociale si facebook dhe Whatsapp.
- I gjejnë në mënyrë të rastësishme në segmente rrugore të caktuara.
- Në rastet e bashkëpunimit, janë të informuar nga anëtarë të tjerë të grupit lidhur me lëvizjen e refugjatëve dhe migrantëve.
- Gjejnë kontakte nga refugjatët/migrantët, të cilët i kanë ndihmuar më parë të kalojnë në mënyrë të paligjshme kufirin.

Nga analiza e vendimeve gjyqësore rezulton se autorët fillimisht i strehonin dhe më pas i transportonin drejt Tiranës, migrantët e parregullt.

Krahas kampionit të vendimmarrjeve të studiuara, tërheqin vëmendjen rrethanat e faktit dhe argumentimi i përdorur nga ana e Gjykatës së Korçës në vendimin 41-2020-732(56) të datës 24.02.2020. Nga rrethanat e faktit të reflektuara në këtë vendim, rezulton se 3 të pandehurit, anëtarë të një familjeje kanë ndihmuar shtetas të huaj refugjat, duke i strehuar dhe transportuar kundrejt pagesës. Ata kishin një hotel, ku i strehonin shtetasit e huaj kundrejt pagesës 10 euro nata. Për refugjatët kujdesej bashkëshortja, e cila u morri edhe kontakte të refugjatëve të tjerë që ishin drejtuar për të kaluar kufirin. Ndërkohë bashkëshorti dhe djali bënë transportin e tyre, ku djali me makinën e tij mundësonte transportin e tyre nga hoteli drejt stacionit të autobuzit. Duke qenë banorë të zonës, transportuesit përdornin një rrugë dytësore, me qëllim që Policia të mos i lokalizonte lehtësisht. Kundrejt pagesës 100 euro bëhej i mundur transportimi i refugjatëve drejt kryeqytetit. Kryefamiljari, i cili rezultonte shofer i një subjekti privat, alternonte transportimin e refugjatëve të parregullt me stafin e një kompanie tjetër private shqiptare, të cilët udhëtonin çdo ditë nga Kamza në drejtim të Korçës e anasjelltas. Nisur nga hetimi gjyqësor rezultonte se të pandehurit e kryenin prej kohësh këtë veprimtari të paligjshme, duke ndihmuar shtetas të huaj që të kalojnë kufirin shqiptar në mënyrë të parregullt, me destinacion vendet e BE-së.

Nga tërësia e vendimeve të dhëna për veprën e ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, vetëm në 1 rast rezulton që ndihma të jetë dhënë nga shtetas shqiptarë për shtetas shqiptarë. Kjo tregon se fokusi i personave të cilët kryejnë këtë veprë penale me qëllim dhënien e ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit janë kryesisht shtetasit e huaj.

1.1.4 Ana subjektive

Në kryerjen e veprës penale, rëndësi të madhe ka dhe qëndrimi që mban autori kundrejt kryerjes së saj. Sa i takon fajësisë, vërehet se në të gjitha rastet autorët kanë vepruar me dashje direkte. Kur kalimi i kufijve shtetëror kryhet nga pakujdesia, psh: për shkak të ngatërimit të rrugës, personi

²⁸ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, Vendimi 41-2021-1284(163), datë 08.04.2021

nuk ka përgjegjësi penale.²⁹ Pra kjo kategori veprash penale, elementin e dashjes e ka të domosdoshëm për t'u kualifikuar si e tillë. Në rastin e vendimmarrjes studimore të disponuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, pasoja e të cilës konsistonte në humbjen e jetës së disa shtetasve, Gjykata evidentoi se krimi është kryer me dashje direkte, me qëllim fitimi spekulativ, duke përfituar nga nevoja që kanë patur shtetasit që donin të kalonin kufirin kundrejt një vlere 600-1500 Euro.

Por nuk përjashtohen raste, kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda (që përbën figurë të veçantë të veprës penale nën rrethana cilësuese), ana subjektive mund të jetë edhe pakujdesi, në formën e neglizhencës apo vetëbesimit të tepruar (psh kur migrantët e parregullt transferohen në kushte të vështira për të mos u zbuluar nga policia). **Në doktrinë**, si faktorë nxitës që shtyjnë individët të largohen nga vendi i tyre njihen gjendja ekonomike e vështirë, situata e respektimit të të drejtave të njeriut si dhe niveli i sigurisë publike. Migrimi në kërkim të punës është shndërruar në një mjet jetese për shkak të mungesës së mundësive për punësim në shumë vende në zhvillim, ndër të cilët edhe në vendin tonë.

Kalimi i paligjshëm i kufirit

Edhe në vendimet e analizuara në këtë studim, rezulton se është pikërisht situata social-ekonomike ajo që i shtyn shtetasit shqiptarë të kalojnë kufirin në këtë mënyrë. Detyruar nga gjendja e vështirë me të cilën përballen, nevoja e gjetjes së një pune jashtë vendit për shkak se në qytetin/fshatin ku jetojnë e kanë të pamundur gjetjen e një të tille ose fitimet janë të pamjaftueshme, mbetet si zgjidhje largimi. Kjo kuptohet edhe në veprimet e tyre, ku sapo kalojnë kufirin fillojnë të kërkojnë për punë të ndryshme në ndërtim apo bujqësi.

Ka raste kur, përveç arsyes ekonomike këta shtetas përdorin këtë mënyrë edhe për shkak se kanë marrë një masë administrative nga shteti ynë të cilën akoma nuk e kanë paguar, apo kanë marrë *apellas* ose ekspuls për një periudhë kohore të caktuar nga vendet fqinje dhe këto pengesa me karakter ndalues ia bëjnë të pamundur kalimin në mënyrë të ligjshme. Në këto raste, autori rezulton përsëritës i këtij veprimi. Në disa raste vërehen edhe disa fenomene sociale që e shtojnë nevojën e largimit të këta persona siç janë të qenit i vetmi anëtar në familje që siguron të ardhura, apo rritja e fëmijëve si detyrim i lënë nga gjykata në rastet e kujdestarisë prindërore³⁰.

Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit

Referuar praktikës gjyqësore objekt i këtij studimi, edhe në rastet e konsumimit të veprës “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, autorët kanë vepruar me dashje direkte. Në shumicën e rasteve, autorë të këtyre veprave nuk rezultojnë shtetas që kanë vendbanimin në qytetin kufitar nga i cili hyjnë migrantët e paligjshëm, por nga qytete të tjera të Shqipërisë, të cilët nisen nga një distancë e largët për të kryer transportimin dhe strehimin e migrantëve, siç mund të jetë Tirana, Durrësi, Elbasani. Kjo mund të tregojë që këta shtetas duan të humbasin gjurmët për të mos u zbuluar nga organet ligjzbatuese. Qëllimi i kryerjes së veprës penale është fitimi, që i shtyn të ndërmarrin këtë vepër, gjë që rezulton edhe nga shumatat të cilat paguhet nga ana e migrantëve të paligjshëm për të mundësuar mbërritjen e tyre në destinacion. Përfitimi ekonomik realizohet duke justifikuar veprimtarinë e tyre kriminale me situatën humanitare në të cilën ndodhen refugjatët/migrantët e parregullt në territor.

²⁹ E drejta Penale-Pjesa e Posaçme. Prof. Dr. Ismet Elezi

³⁰ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendimi nr. 23-2020-790/159, datë 02.07.2020

1.1.5 Pasoja e ardhura nga kryerja e veprave penale

Në referim të nenit 298 të Kodit Penal, “Ndhima për kalimin e paligjshëm të kufirit” parashikon disa rrethana të cilësuar të cilat lidhen ndër të tjera, kur vepra ka sjellë pasoja të rënda.

Në këtë seksion të punimit kemi menduar të ndalemi në pasoja që vijnë nga kryerja e kësaj vepre si një pjesë shumë e rëndësishme e analizës së gjithë fenomenit të kontrabandimit të migrantëve dhe që nuk duhet anashkaluar. Për shkak të mundësisë së zbulimit nga autoritetet ligjzbatuese apo patrullat e policisë, për shkak të presionit apo frikës që mund të ndiejnë por dhe rrethanave të papritura që nuk janë në dorë të autorit, vepra ndodh të mos realizohet plotësisht. Si rrjedhojë, mund të ketë pasoja fatale nga dëmtimi i shëndetit apo humbja e jetëve të migrantëve që kontrabandohen.

Në tërësinë e 106 vendimeve të analizuara, si rast me pasoja shumë të rënda rezulton vetëm 1 rast për të cilën gjykata ka marrë vendim, ndërsa në vendimmarrjet e tjera nuk janë pasqyruar të dhëna për pasoja ndaj viktimës/ave të veprës penale. Ky rast i shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë³¹ reflekton situatën e 3 të pandehurve shtetas shqiptarë, të cilët kanë bashkëpunuar për të ndihmuar 27 shtetas nga qytete të ndryshme të Shqipërisë për të kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme për në shtetin grek. Sipas hetimeve rezulton se ata do të niseshin nga Kalaja e Butrintit dhe më pas nëpërmjet kanalit në liqenin e Butrintit do arrinin të kalonin kufirin për në shtetin fqinj, pa u vënë re nga policia, e cila kishte postoblok 100 metra larg, në vendin e quajtur Lundra. Rezulton se fillimisht është siguruar mjeti tip varkë peshkimi me gjerësi 2 m dhe gjatësi 4.5 m me të cilën shtetasit do kalonin në anën tjetër të kanalit. Fillimisht janë kaluar në anën tjetër 12 persona, pas 10 minutash varka është kthyer për të marrë dhe 17 personat e tjerë, ndër të cilët edhe 3 bashkëpunëtorët. Pas nisjes nga Bregu, fëmija i vogël ka nisur sërish të qajë dhe në mënyrë që të mos zbuloheshin nga Policia, njëri prej autorëve u ka kërkuar prindërve që të pushonin vajzën e tyre, duke ua bërë të qartë se po bëhej problem. Nga lëvizjet e herëpashershme varka pësoi ulje në nivelin e ujit në pjesën e pasme, dhe u fundos menjëherë në liqen. Vendi i përmbytjes konsiderohej me një thellësi të madhe, ndërkohë që jo të gjithë shtetasit dinin not. Disa prej tyre u mbytën, ndërkohë që disa të tjerë mundën që të shpëtonin e të dilnin në breg duke u larguar menjëherë. Në këtë incident të ndodhur, humbën jetën 5 shtetas, ndër të cilët edhe foshnja e mitur me 2 prindërit e saj.

1.2 Subjektet e dyshuara si autor të veprave penale

Recidivizmi i të pandehurve

Në kuptimin juridiko-penal, recidivizmi lidhet me rikthimin e autorit të veprës penale në sjellje të njëjtë ose të tjera kriminale, pasi ai është shpallur fajtor, me vendim gjyqësor të formës së prerë. Sipas Kodit Penal, recidivizmi përbën një element rëndues e përcaktues në vendimmarrjen e Gjykatës, kur deklarohet fajësia e të pandehurit. Konkretisht, kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë, parashikohet si rrethanë rënduese nga neni 50 gërma “ç” e K.P, e cila mbahet parasysh nga gjykata në momentin e caktimit të dënimit. Përsëritja në krim,

³¹ Vendim nr. 23-2015-40 të datës 08.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë

pëbën një kriter për caktimin e masave të sigurimit personal, sipas parashikimeve që bën neni 229 pika 2 e Kodit të Procedurës Penale.³²

Nga përpunimi statistikor dhe cilësor i vendimeve gjyqësore rezultojnë se janë 75 të akuzuar me gjendje gjyqësore “të padënuar më parë” dhe 25 të akuzuar me gjendje gjyqësore të dokumentuar “i/e dënuar më parë”. Ndërkohë që ndaj 11 shtetasve të akuzuar vendimmarrjet nuk ofrojnë informacion, megjithatë 3 shtetas rezultojnë të jenë arratisur më herët në Turqi, por nuk referohen të dhëna identifikuese mbi recidivizmin e tyre. Këto statistika tregojnë se totali i personave të dënuar më parë dhe që shfaqen si përsëritës në krim, përbën rreth 22% të numrit total të personave të akuzuar. Do të ishte në interes të jurisprudencës, në aspektin studimor dhe doktrinar, që përgjatë procesit gjyqësor dhe rrjedhimisht në këto vendime të evidentoheshin shkaqet që kanë ndikuar në recidivizëm tek të pandehurit.

E drejta ankimit ndaj vendimeve gjyqësore

Në 2 raste rezultojnë se e drejta e ankimit është ushtruar nga ana e prokurorit të çështjes, ndërkohë në 8 raste kanë qenë vetë të pandehurit që e kanë ushtruar këtë të drejtë. Gjithashtu, nga analiza e vendimmarrjeve rezultojnë se ndaj 14 të pandehurve, gjykata ka vendosur vetëm pranimin e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit³³, ndërkohë që faza e hetimeve paraprake ka vijuar, me qëllim caktimin e masës së dënimit proporcional me rolin e secilit autor të dyshuar.

1.2.1 Të pandehurit me statusin e funksionarit publik

Nga 106 vendimet e analizuara rezultoi se asnjë prej të pandehurve nuk përfaqëson një subjekt të posaçëm, si rrjedhojë asnjë prej tyre në momentin e ngarkimit me përgjegjësi penale nuk konstatohet se ka qenë mbajtës i një funksioni publik ose të ketë qenë punonjës i administratës.

1.2.2 Femrat dhe të miturit si autorë dhe viktimë të veprave penale

Të gjithë të pandehurit dhe të dënuarit për kategorinë e figurave të veprave penale të cilat përfshihen nën fenomenin e kontrabandimit të migrantëve janë qytetarë në moshë madhore dhe me përgjegjësi të plotë penale. Për sa i përket autoreve të gjinisë femërore është konstatuar një numër i ulët prej 6 vajza dhe gra. Në shumicën e rasteve, në përputhje me parimin e humanizmit, vihet re një qëndrim më i butë dhe favorizues kundrejt të akuzuarve të gjinisë femërore, si nga organi i akuzës por edhe nga gjykata në caktimin e dënimit.

Këtë qëndrim nuk e shohim në rastin e vendimit të Gjykatës së Sarandës nr 23-2017-1021(159), datë 31.05.2017, me anë të të cilit gjykata vendosi dënimin e të pandehurës me gjobë në masën 100.000 lekë. Ky është një nga dënimet me gjobë më të lartë, i përdorur vetëm në 3 raste të tjera.³⁴ Arsyeja e gjykatës për sa i takon individualizimit të dënimit dhe caktimit të masës së dënimit, është i munguar, ndërkohë që praktika gjyqësore rezultojnë të jetë e dystandartizuar nëse i

³² Neni 229/2 i K.Pr.P “Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal.”

³³ Janë aplikuar 2 lloje masash sigurimi:

- Mase sigurie "Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore"
- Mase sigurie "Arrest me burg"

³⁴ Gjykata e Sarandës vendimi nr. 23-2017-860(135), datë 04.05.2017
Gjykata e Sarandës vendimi nr. 23-2019-2342(309), datë 27.12.2019
Gjykata e Sarandës vendimi nr. 23-2016-1763/266, datë 27.09.2016

referohemi masës së gjobës në vlerën 60,000 Lekë (e dhënë nga e njëjta gjykatë e Sarandës). Vlen të theksohet se në këto raste që kanë shërbyer për arritjen e këtij përfundimi, rrethanat e ngjarjeve janë pothuajse identike.

Një aspekt i rëndësishëm në të cilin është fokusuar përpunimi i të dhënave nga ky studim lidhet me identifikimin e rasteve apo rrethanave dhe konstatimeve, të cilat japin të dhëna për viktimat e veprës penale, femra apo të mitur. Koncepti i viktimës ekziston në interpretimin e elementëve të anës objektive të veprës penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” dhe në teori, çdo person i kontrabanduar (pavarësisht nëse ndaj tij apo saj kanë ardhur apo jo pasoja nën rrethanat e cilësuar të parashikuara në këtë vepër) është edhe viktimë e kësaj vepre penale. Fenomeni i kontrabandës së migrantëve, mbart rreziqe të shtuara, jo vetëm për sigurinë e kufijve apo integritetin territorial të shtetit, por për shkak të pozitës vulnerabël në të cilën ndodhen personat të cilët përfshihen në këto lëvizje. Ndaj këtyre shtetasve ekziston rreziku i shtuar i cënimit të jetës apo shëndetit të tyre, ndërkohë që për kontrabanduesit dhe grupet kriminale përvetësimi i përfitimit material është i vetmi qëllim që ata kanë.

Vendimi nr. 23-2015-40 (9) i dhënë nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është i vetmi vendim ku nga konsumimi i veprës penale “ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” ka ardhur si pasojë vdekja e 5 personave, tre meshkuj, një femër dhe një e mitur foshnjë.

1.2.3 Llojet e masave të sigurimit personal të kërkuara dhe aplikuar ndaj të pandehurve

Nga 106 vendime të analizuar në total rezulton se prokuroria ka bërë 14 kërkesa për vendosjen e masave të sigurimit personal ndaj të pandehurve, prej të cilave, 12 janë për masën “Arrest në burg”, dhe 2 prej tyre konsistojnë në “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Të gjitha kërkesat e depozituara nga ana e organit të Prokurorisë për vendosjen e masës së sigurimit personal ‘arrest në burg’ ndaj shtetasve të pandehur, janë pranuar nga ana e Gjykatës. Vetëm në 1 rast ka ndodhur që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, Vendimi nr xxx datë 16.01.2021, pasi ka caktuar masën e sigurimit arrest në burg, ka vendosur zëvendësimin e saj bazuar në nenin 236 të K.Pr.Penale, duke urdhëruar lirimin e personit, si dhe duke aplikuar “garanci pasurore” ndaj tij.

Masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” është vendosur nga Gjykata e Pogradecit për një shtetase polake e cila është e dyshuar për veprën penale të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit sipas nenit 298 KP. Në arsyetimin e saj, gjykata ka marrë parasysh faktin se kjo shtetase është e martuar dhe ka një fëmijë të mitur në një shkollë në Durrës. Rasti i dytë i caktimit të kësaj mase sigurie është nga Gjykata e Korcës. I pandehuri në këtë vendim gjithashtu akuzohej për veprën penale të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit. Gjykata në caktimin e masës së sigurimit ka marrë parasysh personalitetin e të dënuarit, faktin që nuk ka qenë i dënuar më parë si dhe rolin e tij si kryefamiljar.

Konstatohet se masa e arrestit në burg është më e kërkuara dhe më e aplikuar nga prokuroria për 22 persona (rreth 20% të vendimeve). Ky trend duket se nuk respekton kërkesat e parashikuara në nenin 230 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit masa ‘arrest në burg’ duhet të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit. Gjithashtu nga analiza studimore është evidentuar se në pjesën dërrmuese të vendimarrjeve të tyre, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore kanë pranuar kërkesën e prokurorit, kryesisht, duke u bazuar në ekzistencën e rrezikut të ikjes së personit ndaj të cilit është kërkuar

aplikimi i masës së sigurisë, si dhe duke mbështetur argumentimin e tyre edhe në rrezikshmërinë e veçantë të veprës së kryer.

Vlen të përmendet se masat e sigurimit personal janë kërkuar dhe janë vendosur vetëm për veprën penale të “Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve” parashikuar nga neni 298 K.P., ndërsa për figurën e veprës penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, të parashikuar në nenin 297 K.P. duke qenë se kjo veprë penale është më e lehtë, në asnjë rast nuk rezulton se nga ana e organit të Prokurorisë të jetë kërkuar caktimi i një mase të sigurimit.

1.2.4 Format e bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe roli i të pandehurve

Referuar të dhënave të përpunuara nga vendimet gjyqësore në asnjë rast nuk kemi evidentuar kryerjen e veprës penale në kuadër të ndonjë prej formave të veçanta të bashkëpunimit. Identifikimi i formave të ndryshme të bashkëpunimit midis organizatorëve të veprës penale ka rëndësi thelbësore për kualifikimin e saktë të veprës penale, por veçanërisht, edhe të kompetencës lëndore të prokurorisë dhe gjykatës kompetente, pasi nëse do të jemi para rasteve të një bashkëpunimi të organizuar në forma të veçanta, kompetente do të ishin SPAK dhe Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, prokuroria e posaçme (SPAK) dhe gjykata e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ndër të tjerash janë kompetente për hetimin dhe gjykimin e çdo veprë penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal. Përcaktimet lidhur me këto forma të veçanta të bashkëpunimit, parashikohen në nenin 28 të Kodit Penal (pjesa e përgjithshme), Të dhënat e kontrabandimit të migrantëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në vendet e BE-së apo edhe në Mbretërinë e Bashkuar, flasin për rrjetë kriminale të organizuara të kryerjes së kësaj veprë penale. Ndërkohë, në Shqipëri, më së shumti ato hetohen dhe gjykohen si bashkëpunim i thjeshtë, çka bën që hetimi i tyre të mos jetë i specializuar dhe të pandehurit të marrin dënime të ulët në raport me dënimin për pjesëmarrje në rrjete të organizuara kriminale për kryerjen e kësaj veprë penale.

Bashkëpunimi i thjeshtë sipas nenit 25 të Kodit Penal që është në kompetencën lëndore të prokurorive dhe gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm për këto vepra penale është forma e konstatuar e organizimit të përbashkët të autorëve të veprës penale, e cila sipas kuptimit të ligjit, quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre.

Ndërkohë, sipas nenit 26 të Kodit Penal bashkëpunëtorë (pra edhe për format e thjeshta të bashkëpunimit që nuk hetohen e gjykohen nga SPAK dhe GJKKP) për kryerjen e veprës penale quhen: organizatorët, ekzekutorët, shtytësit dhe ndihmësit.³⁵ Gjatë studimit është evidentuar mungesa e konstatimit mbi ndarjen e roleve ndërmjet autorëve të veprës penale, pothuajse në të gjitha rastet nga ana e prokurorisë në kërkesën e saj për dënimin e shtetasve të dyshuar. Në rastet e vendimeve gjyqësore në të cilat evidentohet ndarja e roleve ndërmjet të pandehurve zakonisht vërehet se të pandehurit kanë luajtur rolet e ndihmësit ose organizatorit. Një vendim i veçantë në lidhje me formën e thjeshtë të bashkëpunimit është ai i dhënë nga ana e Gjykatës së Rrethit

³⁵ Neni 26 K.P, Bashkëpunëtorët “Organizatorë quhen ata persona që organizojnë dhe drejtojnë veprimtarinë për kryerjen e veprës penale. Ekzekutorë janë personat që kryejnë veprime të drejtëpërdrejta për realizimin e veprës penale. Shtytës quhen personat që nxisin bashkëpunëtorët e tjerë për kryerjen e veprës penale. Ndihmës quhen personat që me këshilla, udhëzime, dhënie mjetesh, largim të pengesave, dhënie të premtimit për fshehjen e bashkëpunëtorëve, të gjurmëve apo të sendeve që rrjedhin nga vepra penale, ndihmojnë për kryerjen e saj.”

Gjyqësor Korçë me nr 41-2021-2209(196), në të cilin gjatë gjykimit për vendosjen e masës së sigurisë “Arrest në burg”, vetë gjykata ngre pretendime bazuar në rrethanat e faktit, për bashkëpunim me persona të painedifikuar pa indicje nga organi i Prokurorisë.

Bashkëpunimi për këtë vepër penale, sipas Gjykatës, nuk është vetëm i rangut kombëtar por edhe ndërkombëtar, duke krijuar një rrjet për kalimin më të lehtë nëpër disa shtete. Rrjedhimisht, në vlerësimin e KShH-se, ky element përforconte konstatimin e meherëshëm që kompetenca lëndore për hetimin e tyre i takon SPAK-ut. Bashkëpunimi ndërkombëtar zbulohet nëpërmjet mjeteve dhe teknikave të specializuara të hetimit si përgjimet telefonike, përgjimet ambientale, etj. Por identifikimi i personave të huaj është shumë i vështirë pa bashkëpunimin e të pandehurit, i cili në shumicën e rasteve nuk ka qasje pozitive. Kjo dikton nevojën për thellimin e bashkëpunimit rajonal midis autoriteteve ligjbaztuese dhe organeve të sistemit të drejtësisë. Dënimi më i lartë i kërkuar nga organi procedues në rastin e bashkëpunimit sipas nenit 298/3 K.P. është 8 vite dhe dënimi më i lartë i dhënë nga gjykata nuk i ka kaluar 5 vite pas aplikimit të gjykimit të shkurtuar.

1.2.5 Kërkesat për gjykim të shkurtuar dhe efektet e tij

Gjykimi i shkurtuar hyn në kategorinë e gjykimeve të posaçme, i cili është parashikuar nga nenet 403-406 të Kodit të Procedurës Penale. Në thelb të tij qëndron zhvillimi i gjykimit në gjendjen që janë aktet e dosjes hetimore duke evituar fazën e hetimit gjyqësor. Kërkesa për gjykim të shkurtuar bëhet nga ana e të pandehurit dhe gjykata vendos për pranimin ose mospranimin e saj.

Referuar 106 vendimeve gjyqësore të studiuara në këtë punim, nga ana e të pandehurve ose përfaqësuesve ligjorë të tyre janë bërë në total 26 kërkesa me shkrim lidhur me këtë lloj gjykimi dhe janë pranuar të gjitha. Gjykatat e rretheve gjyqësore, në pjesën dërrmuese të rasteve kur ka marrë një kërkesë të tillë, kanë pranuar me vendimmarrje të ndërmjetme gjykimin e shkurtuar, duke argumentuar se çështja objekt gjykimi mund të shqyrtohej në gjendjen që janë aktet.

Kuptohet se me anë të kësaj kërkesë të pandehurit që kanë kërkuar gjykim të shkurtuar (kërkesa e të cilëve është pranuar) kanë hequr dorë në mënyrë të vullnetshme nga disa të drejta që i referohen procesit të rregullt ligjor, siç është ajo e barazisë së armëve në gjykim apo dhe e formimit të provës nën parimin e kontradiktoritetit gjatë hetimit gjyqësor. Një ndër përfitimet që sjell gjykimi i shkurtuar, edhe pse ai nuk duhet të nënkuptojë fajësi, është ulja e dënimit me 1/3 e tij, nëse i pandehuri deklarohet fajtor nga gjykata³⁶.

Lidhur me efektet që ka sjellë pranimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar, KShH vëren se nga aplikimi i këtij lloj gjykimi kanë rezultuar këto lehtësira procedurale:

- *Së pari*, janë shkurtuar procedurat dhe është rritur shpejtësia dhe efektiviteti i gjykimit;
- Për rrjedhojë, edhe kostot për palët kanë qënë më të ulta se sa mund të ishin në rastin e gjykimeve të zakonshme, duke i shërbyer pozitivisht ekonomisë gjyqësore;
- *Së treti*, të pandehurit dhe të dënuarit kanë përfituar uljen në 1/3 e masës së dënimit për veprën e kryer. Kështu 37 persona të akuzuar kanë përfituar ulje të dënimit nga aplikimi i gjykimit të shkurtuar nga gjykatat e pesë rretheve gjyqësore.

³⁶ Neni 406 KPrP Vendimi, Kur jep vendim dënimi gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën. Dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me tridhjetë e pesë vjet burgim.

SEKSIONI 2

“POLITIKA PENALE E NDJEKUR NGA INSTITUCIONI I PROKURORISË DHE GJYKATA”

1.3 Llojet dhe masat e dënimit të caktuara nga ana e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore

Sa i përket dënueshmërisë, për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit (n.297 i Kodit Penal) është parashikuar dënim me gjobë ose me burgim gjer në 2 vjet, ndërkohë që për veprën penale të ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit (n.298 i K.Penal), është parashikuar vetëm dënimi kryesor me burgim dhe dënimi kryesor me burgim të përjetshëm.

Vlen të theksohet se, Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se qëllimi i secilit prej dënimeve kryesore të parashikuara në Kodin Penal është i ndryshëm. Dënimi me burgim, duke konsistuar në një privim të lirisë, është konceptuar në të drejtën penale, edhe në kuptim të parimit të *favor libertatis* (në favor të lirisë), si *extrema ratio* (masë ekstreme). Pra, duke qenë se dënimi me burgim passjell sakrifikimin maksimal të lirisë personale të personit, kjo e fundit e mbrojtur nga Kushtetuta, ai është konsideruar nga ligjvënësi si masa e fundit shtrënguese si dhe dënimi më i rëndë ndër dënimet kryesore. Ndërsa, dënimi me gjobë lindi si një mënyrë për të shmangur dënimin me burgim, pasi konsiderohej si më e drejtë që personi të mund të paguante një shumë të hollash për vepra që kishin një rrezikshmëri të ulët shoqërore, pa pasur nevojë që të privohej nga liria³⁷.

Për të analizuar mirë llojet dhe masat e dënimit të caktuara nga gjykata fillimisht do të na duhet të bëjmë një ndarje në bazë të dispozitave, të referuara në ngarkim të tyre.

✦ Kategorizimi i llojit dhe masës së dënimit

Në rastet e studiuara, janë konstatuar 95 shtetas të akuzuar për të cilët është dhënë një vendim fajësie, qoftë ky i formës së prerë ose jo. Dënimet e mundshme të aplikueshme janë ai i dënimit me gjobë ose burg. Sa i takon llojit të dënimit të vendosur nga Gjykatat konstatohet se është aplikuar më së tepërmi dënimi me gjobë në 77 raste, pasuar nga ai me burgim në 18 raste. Në 86 vendimmarrje të kualifikuara nën nenin 297 K.P., ndaj 77 rasteve prej tyre ose rreth 89.5% janë sanksionuar me masë administrative (gjobë) nga ana e Gjykatës, ndaj 3 rasteve janë caktuar dënime alternative të dënimit me burg sipas nenit 59, dhe 18 prej tyre janë dënuar me burgim.³⁸

Shuma më e lartë e gjobës së kërkuar nga ana e organit të Prokurorisë, që është pranuar dhe vendosur nga Gjykata rezulton në vlerën, 150.000 lekë. Masa më e ulët e gjobës e kërkuar nga prokuroria rezulton në vlerën 50.000 lekë, ndërkohë që Gjykata ka caktuar masën më të ulët të gjobës në vlerën 40.000 lekë³⁹.

³⁷ Shih vendimin nr.19, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese

³⁸ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, Vendimi nr 22-2018-62 datë 22.02.2018
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, Vendimi nr 43-2021-75 datë 25.01.2021
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, Vendimi nr 43-2021-430 datë 26.04.2021
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendimi nr 23-2016-1930-/289 datë 14.10.2016
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendimi nr 23-2017-905 datë 11.05.2017

³⁹ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendimi nr 23-2016-1332 datë 01.07.2016
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendim nr 23-2016-1925(287) datë 13.10.2016
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendim nr 23-2016-1094(155) datë 31.05.2016

Edhe pse në masë më të ulët, dënimi me burgim është dhënë me një maksimum 1 vit, kundrejt një shtetasi turk, ndërkohë që minimumi i dënimit me burgim është konstatuar në një nga çështjet, përkatësisht me 10 ditë burgim⁴⁰. Duke mbajtur në konsideratë se neni 297 K.P përkufizohet si kundërvajtje penale, dënimi me burg nisur nga praktika gjyqësore nuk është një praktikë e zakonshme, rrjedhimisht nuk përmbush qëllimin për riedukimin dhe rehabilitimin e autorit.

Referuar nenit 298 K.P. “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, ligjvënësi ka parashikuar përshkallëzim të masës së dënimit që varion nga një vit burg deri në burgim të përjetshëm, në varësi të rrethanave cilësuese të ndryshme që parashikohen në paragrafët e veçantë të kësaj dispozite.

1.3.1 Trendi i caktimit të alternativave të dënimit me burgim

Si shprehje e humanizmit të legjislacionit penal, por edhe si një mjet i cili ndihmon rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të përfshirë në sjellje kriminale, Kodi Penal ka parashikuar në kreun 7 të tij alternativat e dënimit me burgim, të përcaktuara në nenet 58-65/a të tij. Ndër këto alternativa parashikohen:

1. *Gjysmëliria*⁴¹
2. *Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë*⁴²
3. *Qëndrimi në shtëpi*⁴³
4. *Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik*⁴⁴
5. *Lirimi me kusht*⁴⁵

Në tërësinë e vendimeve të analizuara rezultojnë se ndaj 18 rasteve nën hetim, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore kanë caktuar dënimin me burgim. Por vetëm në tre raste janë konstatuar se janë aplikuar alternativat e dënimit me burgim, konkretisht ajo e “pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” parashikuar nga neni 59 i K.P dhe në një rast tjetër është aplikuar alternativa e dënimit me burgim “pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik” parashikuar nga neni 63 i K.P. Në dy prej këtyre rasteve, dënimi alternativ është caktuar për figurën e veprës penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, të parashikuar në nenin 297 të Kodit Penal, ndërkohë që në 1 rast rezulton të jetë aplikuar ndaj veprës penale të ‘ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit’.

Konkretisht, në një nga çështjet e përmendura në paragrafin e mësipërm, Gjykata e Shkallës së Parë Pogradec, me vendimin Nr.650-121, datë 09.06.2021 vendosi dënimin me 2 muaj burg, për një shtetas që u deklarua fajtor për veprën penale të “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, të parashikuar në nenin 297 të Kodit Penal. Në bazë të nenit 59 K.P., Gjykata vendosi të aplikojë pezullimin dhe vënien në provë të këtij shtetasi, për një periudhë prej 4 muajsh. Aplikimi i alternativës së dënimit me burgim u shoqërua me kushtin që gjatë kohës së provës, i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale. Nga rrethanat faktike të çështjes objekt gjykimi, i pandehuri, i cili

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendim nr 23-2016-1024/144 datë 20.05.2016

⁴⁰ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, Vendim nr 43-2021-75 datë 25.01.2021

⁴¹ Neni 58 i Kodit Penal

⁴² Neni 59 i Kodit Penal

⁴³ Neni 59/a i Kodit Penal

⁴⁴ Neni 63 i Kodit Penal

⁴⁵ Neni 64 i Kodit Penal

rezultonte shtetas shqiptar kishte kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme, duke pasur si destinacion përfundimtar Spanjën. Rezulton se ai ka kaluar fillimisht nga kufiri i gjelbër në Maqedoninë e Veriut ku ka qënduar për një muaj, më pas është nisur drejt Francës dhe aty ka hipur fshehtas në një kamion për të shkuar në Spanjë, ku edhe është kapur nga policia franceze e cila e ka kthyer në Shqipëri.

Në analizë të vendimit gjyqësor evidentohet se gjykata në arsyetimin e saj vlerësoi se i pandehuri i plotësonte të gjitha kushtet për aplikimin e dënimit alternativ pasi:

1. Masa e dënimit e caktuar ndaj tij ishte e ulët, brenda marzhit të përcaktuar në dispozitën përkatëse, prej 2 muaj burgim;
2. Duke analizuar rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe qasjen e të pandehurit ndaj saj, veçanërisht duke marrë në konsideratë pendesën e të pandehurit për kryerjen e veprës penale, gjykata konkludoi se i pandehuri paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore;
3. Gjykata në aplikimin e alternativës së dënimit me burgim, mban parasysht të kaluarën e tij kriminale, nga ku rezulton se ky shtetas ka qenë i padënuar më parë;
4. Në respektim të parimit të humanizmit, gjykata çmon se dënimi më burgim nuk do të shërbente për riedukimin e të pandehurit, në mënyrë që ai të rikthehet në shoqëri.

Për këto arsye, Gjykata, në vlerësim të drejtë dhe harmonik të elementëve të evidentuar më sipër, të verifikuar gatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në përputhje me pikën 3 të nenit 59⁴⁶ vendosi vënien në provë të pandehurit për një periudhë prej 4 muajsh, me kusht që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.

Çështja e dytë, në të cilën është vendosur dhënia e një dënimi alternative i përket Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet. Kjo gjykatë, me Vendimin nr.22-2018-62 të datës 22.02.2018 vendosi dënimin me 2 muaj burg për të pandehurin e akuzuar për veprën penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, parashikuar në nenin 297 të Kodit Penal. Në bazë të nenit 63 të K.P, gjykata vendosi pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik për një kohë prej 50 orë pune, e cila duhet të kryhet brenda 6 muajve. Në këtë çështje, nga analiza e vendimit të gjykatës rezulton se i pandehuri ka kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme, nëpërmjet kufirit të gjelber me këmbë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes është verifikuar se arsyeja e kryerjes së kësaj vepre penale, e pranuar edhe nga personi i dyshuar si autor i veprës penale, lidhet me qëllime ekonomike, konkretisht punësimin e tij në vendin fqinj. Rezulton se shtetasi së bashku me nje shok të tijin e kanë kaluar kufirin shtetëror duke ecur në këmbë për një ditë dhe një natë, dhe pasi janë lokalizuar është bërë i mundur arrestimi i tyre në flagrancë nga ana e policisë greke, në territorin e shtetit grek. I pandehuri nuk rezulton se ishte posedues i dokumentave të rregullta për udhëtimin e tij jashtë vendit, ndërkohë që nga verifikimi i sistemit TIMS rezulton se i pandehuri e ka kryer disa herë këtë veprim në formën e kundravajtjes administrative edhe është dënuar me masë administrative gjobë në 2 raste.

Edhe në këtë rast Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, në arsyetimin e saj vlerësoi se i pandehuri i plotësonte të gjitha kushtet për aplikimin e dënimit alternativ si mundësia më e mirë e cila i shërben rehabilitimit dhe riintegritimit të tij në shoqëri, për disa arsye, të cilat në analizë të vendimmarrjes mbi këtë çështje rezultojnë të jenë:

⁴⁶ “Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata.”

1. Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vlerësuar nga gjykata se i pandehuri paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore.
2. Është konstatuar prej Gjykatës se i pandehuri është i dënuar penalisht më parë, por jo për të njëjtën veprë, pasi ai është ndëshkuar më parë për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/1 K.P.⁴⁷
3. Rrethanat e kryerjes së veprës penale nuk janë kategorizuar si të rënda.
4. Është vërtetuar nga gjykata, por edhe nga deklaratimet e të pandehurit se ai e ka kaluar kufirin shtetëror me qëllim punësimi.

Për këto arsye, gjykata sipas nenit 297 të K.P vendosi dënimin me 2 muaj burg, dhe në bazë të nenit 63 të K.P., pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik për një kohë prej 50 orë pune, e cila duhet të kryhet brenda 6 muajve.⁴⁸

1.3.2 Zbatimi i dënimit penal me gjobë

Sikurse është evidentuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, qëllimi i dënimit kryesor me gjobë (si një masë më pak shtrënguese në raport me dënimin me burgim), në frymën e Kushtetutës, duhet rilexuar në kuptimin që funksioni riedukativ, për disa vepra të caktuara penale, mund të përmbushet edhe nga pagesa e një shume të caktuar, pa qenë nevoja që personi të privohet nga liria vetjake⁴⁹. Mgjth, pavarësisht se dënimi me gjobë konsiderohet si një masë më pak shtrënguese, i aplikuar në kushtet e nenin 297 të Kodit Penal, për shtetas që kalojnë kufirin për qëllime ekonomike (punësimi), kjo rëndon pozitën ekonomike të tyre duke i çuar ata drejt recidivizmit. Ndaj në një situatë të tillë, aplikimi i dënimeve alternative të dënimit me burg mund të jetë një masë më lehtësuese për gjendjen e tyre ekonomike.

Në analizë të 106 vendimeve të përpunuara në kuadër të këtij studimi rezulton se dënimi me gjobë është aplikuar për 77 raste ose në rreth 72.6% të rasteve të studiuara me anë të këtyre vendimeve. Evidentohet fakti se dënimi me gjobë si dënim kryesor penal, i parashikuar nga neni 29 paragrafi i parë pika 3 e K.P është dënimi më i përdorur nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit. Në vendimet e dhëna, gjykatat kanë marrë parasysh për caktimin e këtij dënimi rrezikshmërinë e ulët shoqërore që kjo kundërvajtje penale paraqet, dhe në caktimin e masës së gjobës në disa raste janë marrë parasysh rrethanat e ngjarjes dhe të dhënat e mëparshme penale të të pandehurve. Një element i rëndësishëm i përfutur nga përpunimi cilësor i vendimeve gjyqësore është fakti se shumica më e lartë e gjobës së aplikuar nga gjykatat është 150.000 lekë⁵⁰ dhe gjoba më e ulët e është 40.000 lekë⁵¹. Dënimi me gjobë në shumën 60.000 lekë është aplikuar në 37 raste dhe përbën masën standarte të këtij dënimi të dhënë më së shumti nga ana e Gjykatës.

Gjatë analizës, kemi evidentuar faktin se në shumicën e vendimeve gjykatat kanë mbajtur të njëjtin qëndrim me prokurorinë, për sa i përket masës së dënimit. Në rreth 20 raste Gjykatat kanë mbajtur qëndrim më të butë duke caktuar masën e dënimit me gjobë më të ulët se ajo e kërkuar nga prokuroria, dhe vetëm në një rast Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur masë më të lartë

⁴⁷ Neni 134 Vjdhja “Vjdhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

⁴⁸ Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë.

⁴⁹ Shih vendimin nr.19, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese

⁵⁰ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendimi nr 23-2017-1057(168) datë 05.06.2017

⁵¹ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendim nr 23-2016-1094(155) datë 31.05.2016

gjobe penale, se ajo e kërkuar nga prokuroria. Sa më sipër evidentojmë se në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë nr. 23-2020-878(170), datë 15.07.2020, prokuroria ka kërkuar vendosjen e dënimit me gjobë në masën 60.000 lekë, ndërsa gjykata ka vendosur dënimin me gjobë në masën 80.000 lekë.

Duke iu referuar rrethanave të faktit në çështjen objekt shqyrtimi rezulton se i pandehuri ka kaluar kufirin shtetëror në mënyrë të paligjshme, nëpërmjet kufirit të gjelbër për në Greqi, ndërkohë që është arrestuar nga ana e Policisë së vendit fqinj. Nisur nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se i pandehuri është deportuar 3 herë për të njëjtën arsye nga shteti grek. Në arsyetimin e vendimit të saj, gjykata konsideroi si rrethanë rënduese gjendjen e tij gjyqësore si të dënuar më parë, ku edhe shkeljet e tij për veprën penale të “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, të parashikuar në nenin 297 të Kodit Penal ishin të përsëritura. Gjithashtu në analizën e provave apo rrethanave të konstatuara në gjykim, vërehet se Gjykata e cilëson të rëndësishme gjendjen e vështirë ekonomike të të pandehurit, si një shkak për kryerjen e veprës penale. Por pavarësisht nga gjendja ekonomike e të pandehurit që është konsideruar si motiv për kryerjen e kësaj vepre penale, Gjykata ka aplikuar një gjobë relativisht më të lartë se minimum apo mesatarja standarte e aplikuar në raste të tjera, çka mund të vendosin në pikëpyetje suksesin e procesit riedukativ, që ndëshkimi penal mund të ketë ndaj autorit, i cili për ta paguar këtë gjobë mund të kryejë të njëjtën tentativë për kalimin e kufirit, duke çuar sërish në recidivizëm.

1.3.3 Cilësia e arsytimit të përdorur nga ana e trupave gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore

Në kuadër të standardeve të përcaktuara nga nenet 42 pika 2 dhe 142/1 të Kushtetutës, si dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut, vendimi gjyqësor duhet të jetë i arsyetuar, i qartë në përmbajtje dhe i plotë në pasqyrimin e rrethanave, në mënyrë që të jetë i lidhur organikisht dhe logjikisht në analizën e rrethanave, fakteve dhe bazën ligjore. E drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është një e drejtë e garantuar e të pandehurve apo personave ndaj të cilëve po zhvillohet një gjykim në kuadër të të drejtës së tyre për një proces të rregullt gjyqësor, e njohur në mënyrë të qartë edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga analiza individuale dhe krahasimore e pjesës arsyetuese të vendimeve objekt i këtij studimi, rezulton se në mjaft raste mungon arsyetimi i plotë, i qartë dhe logjik. Në pjesën më të madhe të vendimeve vërehen arsyetime formale dhe standarte, pa u fokusuar tek çështja konkrete, ndërkohë që më së shumti ndryshojnë gjeneralitetet e palëve ndërgjyqëse dhe periudhat kohore, duke reflektuar një gjuhë të përgjithshme të ngjashme dhe uniforme. Kryesisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë vërehet se ka disponuar nëpërmjet vendimmarrjeve të strukturuar në një format tip, duke mos evidentuar dhe rrjedhimisht arsyetuar në pjesën e individualizimit të dënimit, elementë të rëndësishëm identifikues të të pandehurit, të tillë si gjendja gjyqësore, moshja dhe gjendja civile.

Sipas nenit 47, paragrafi 2 i Kodit Penal, në caktimin e dënimit ndaj personit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në funksion të vlerësimit sa më të mirë të këtyre elementëve, vërehet se Gjykatat e Rretheve Gjyqësore nuk i kanë kushtuar rëndësi motivit të kryerjes së veprës që do të ndihmonte për një individualizim më të mirë të llojit dhe masës së dënimit.

Në situatat në fjalë motivi që i ka shtyrë këta individë të kryejnë shkelje të ligjit janë kushtet e vështira social-ekonomike (aq sa disa prej tyre nuk mund të përballojnë kostot e pajisjes me mjet identifikimi, siç është pasaporta⁵²). Përmbushja e qëllimit ri-edukativ dhe rehabilitues që ka dënimi, është një element i rëndësishëm i cili duhet të mbahet parasysh nga gjykata në momentin e dhënies së vendimit. Ndaj në analizë të vendimeve gjyqësore, vlerësojmë se aplikimi i dënimeve me gjobë nuk e përmbush këtë qëllim (sikurse e kemi theksuar dhe më herët). Përkundrazi, mund të jetë shkak që shtetasit të rikthehen në përsëritës/recidivistë në shkeljen e ligjit. Ky konstatim përforcohet duke mbajtur në konsideratë se autorët e dyshuar për kryerjen e veprës penale të 'kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror' janë nxitur nga shkaqe ekonomike, pasi fokusi i tyre ka qenë punësimi në vendin fqinj. Evidentohet se në vendimet e studiuara, të gjithë të pandehurit e dyshuar për kryerjen e kësaj veprë penale janë deklaruar përpara Gjykatës të papunë dhe pa asnjë burim tjetër financiar, shkak i cili ka shërbyer si motiv për të kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme, në mënyrë që të sigurojnë një punë të qëndrueshme në vendin fqinj.

Ndër rastet e analizuara, ka tërhequr vëmendjen tonë rasti i një shtetaseje të dënuar më parë po me gjobë⁵³, por ndërkohë që e pandehura gjykohet për të dytën herë radhazi ajo rezulton se ende nuk e ka shlyer detyrimin e parë ligjor, duke e shndërruar dënimin e parë të paekzekutueshëm. Një vendimmarrje e tillë vlerësojmë se ka pasur efekt në recidivizmin e kësaj shtetaseje, ndërkohë që gjendja socio-ekonomike e ka rënduar më tepër statusin e saj procedural. Në këtë rast, si dhe në raste të ngjashme, vlerësojmë se Gjykatat mund të kishin analizuar mundësinë e aplikimit të masave të dënimit alternativ me burgim.

1.3.4 Raste të shpalljes së pafajësisë

Në 106 vendimeve gjyqësore të analizuara, gjykata ka vendosur pafajësinë në vetëm një vendim, pra në më pak se 1% të vendimeve. Ky vendim është marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër⁵⁴. Sipas rrethanave të faktit, rezulton se i pandehuri akuzohet për kryerjen e veprës penale "Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror" sipas parashikimeve të nenit 297 KP dhe nga organi procedues është kërkuar dënimi me gjobë në vlerën 500.000 lekë.

Nga shqyrtimi gjyqësor i rrethanave të ngjarjes, çmojmë me vlerë të evidentojmë, konstatimet e gjykatës në vendimin konkret:

- Në datë 02/10/2018 i pandehuri është kthyer si person i kategorisë "Deportiv"⁵⁵.
- Nga verifikimi në sistemin TIMS⁵⁶ rezulton se ky shtetas nuk ka dalje nga territori i RSH që pas hyrjes së tij në datë 28/03/2018.
- Shtetasi ka kaluar kufirin në pikën Muriqan dhe pas hyrjes në Malin e Zi ka kaluar me këmbë kufirin e shteteve të Kroacisë - Bosnjës - Sllovenisë me synim si destinacion final Mbretërinë e Bashkuar.
- I pandehuri deklaroi se ka kaluar pa iu shmangur kontrollit kufitar, me mjet identifikimi pasaportën biometrike dhe nuk ka dijeni se përse nuk është regjistruar.

⁵² Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë Nr.23-2017-686(110), datë 11.04.2017

⁵³ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Vendim nr 23-2017-1021(159) datë 31.05.2017

⁵⁴ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Vendimi nr 51-2021-175 datë 03.05.2021

⁵⁵Deport - dëbimi i ligjshëm nga një vend i një të huaji, zakonisht për shkak të statusit të paligjshëm ose për kryerjen e një krimi

⁵⁶Sistemi TIMS është një bazë të dhënash elektronike i menaxhimit të kontrollit të kufijve që administrohet nga Drejtoria e Policisë së Shtetit në cilësinë e kontrolluesit.

- Nga kontrolli i fletëve të pasaportës rezulton se ai ka hyrje të rregullt në shtetet e tjera të përmendura nga vulat në pasaportë.

Duke patur parasysh këto të dhëna, gjykata doli në përfundimin e deklaramit të pafajësisë duke u bazuar tek vetë parimi i prezumimit të pafajësisë⁵⁷ parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, dhe me argumentin kryesor, pamundësinë e organit procedues për të provuar fajësinë tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Në vendimin e argumentuar, Gjykata argumenton *“se në rastin konkret nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistenca e faktit, se i pandehuri të ketë kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin e shtetit shqiptar, për sa kohë që në pasaportën e tij gjenden vula të shteteve të tjera fqinje, të cilat mbajnë datën 12.09.2018, e cila është edhe datë kur pretendohet nga i pandehuri se ka dalë për herë të fundit nga territori i Republikës së Shqipërisë. Gjykata konstaton se nuk është detyrë e të pandehurit të provojë pafajësinë e tij, por nga ana e tij në hetimet paraprake u pretendua se është paraqitur në pikën e kalimit kufitar, duke paraqitur dokumentin e udhëtimit, ku më pas është lejuar të kalojë normalisht.”*⁵⁸

Gjykata, bazuar në nenet 378 - 390 të Kodit të Procedurës Penale vendosi deklaramin e pafajshëm të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të "Kalim i paligjshëm të kufirit shtetëror", parashikuar nga neni 297 të Kodit Penal, pasi në bazë të nenit 388, gërma "d" e K.Pr.Penale nuk provohet kryerja e veprës penale nga i pandehuri.⁵⁹

KShH vlerëson se përballja e një shtetasi me akuzën penale sjell pasoja të konsiderueshme jo vetëm ekonomike, por edhe psikologjike e emocionale për të dhe/ose familjarët e tij/saj. Akoma më e rëndë paraqitet situata kur akuzat e ngritura nga prokuroria nuk bazohet në prova të mjaftueshme dhe të besueshme që provojnë fajësinë.

1.4 Politika penale ndaj të shtetasve nga vendet e treta, të gjykuar pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore shqiptare

Të huajt që hyjnë në territorin e vendit tonë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në ligj, kategorizohen si të huaj me qëndrim të parregullt dhe janë subjekt i masave për largimin e tyre nga territori ynë. Në përputhje me këtë standard, vihet re se pesë Gjykatat e Rretheve Gjyqësore vendimmarrjet e të cilave janë studiuar nuk kanë dhënë dënime penale për të huajt që janë ndihmuar për të kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme. Madje ata përmenden vetëm në analizën e rrethanave të faktit, dhe i gjithë procesi është zhvilluar në ngarkim të personit (të pandehurit) të akuzuar se ka bërë transportin e tyre, për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” parashikuar nga neni 298 i K.P.

⁵⁷Lidhur me kuptimin e këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 57, date 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: "Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza."

⁵⁸Vendim i Gjykatës së Shkodrës me nr 51-2021-175.

⁵⁹Neni 388/1, germa d e K.Pr.Penale, ku parashikohet se: Gjykata merr vendim pafajësie kur: d) nuk provohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet".

Në përgjithësi, kjo politikë e ndjekur nga Gjykatat objekt studimi në parim duket e drejtë, pasi emigrantët e parregullt duhet të trajtohen në bazë të procedurave administrative të parashikuara në legjislacionin specifik për të huajt dhe nuk duhet të jenë subjekt i ndjekjes penale për kalimin e paligjshëm të kufirit sipas nenit 297 të legjislacionit penal material. Kjo sepse shtetet kanë interes për largimin/kthimin efektiv të emigrantëve të parregullt dhe jo ndëshkimin penal të tyre⁶⁰. Gjithashtu, kjo politikë penale tregon edhe një qasje humanitare, veçanërisht ndaj asaj kategorie shtetasish që vijnë nga vendet që janë në luftë, ku sistemi demokratik është i minuar, ku persekutohen për shkak të bindjeve të tyre politike apo rrethanave të tjera.

Në një rast Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në kundërshtim me praktikën e mbajtur nga gjykatat e tjera të vendit, ka dënuar penalisht një shtetas palestinez, i cili nisur nga rrethanat e faktit të çështjes rezulton se ka kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme. Sipas vendimit nr.43-2021-430 datë 26.04.2021 i pandehuri ishte nisur nga vendi i tij Palestina, me qëllim për të shkuar në vendet europiane. Itinerari i ndjekur nga ana e të pandehurit konsistonte në kalimin e territorit turk dhe më pas atij grek. Në kufirin shtetëror turko-grek, i pandehuri konstatohet se ka takuar një shtetas sirian të cilin nuk e njihte. Ky i fundit e ka ndihmuar të pandehurin për të hipur ne rimorkion e një kamioni kundrejt pagesës. I pandehuri ka udhëtuar për 3 ditë deri në momentin që policia e gjeti gjatë kontrollit në kufirin shqiptar. Gjithashtu, nga hetimi ka rezultuar se shoferi turk i kamionit që kishte si destinacion Shkodrën nuk kishte djeni për prezencën e shtetasit palestinez në rimorkion e tij.

Gjykata në vendimarrjen e saj e mbështeti dënimin e kërkuar nga organi i Prokurorisë, 2 muaj burg. Nga analiza e të gjitha vendimeve të dhëna nga gjykatat për veprën penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit” ky është dënimi me llojin dhe masën më të lartë të dënimit të caktuar në ngarkim të një shtetasi.

Përveç Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka marrë një vendim për vendosjen e masës së sigurimit me të pandehur një shtetas irakian i cili kishte statusin e azilkërkuesit. Në vendimin nr.1477 të datës 0.05.2021 Gjykata ka vendosur masën e sigurimit “Arrest në burg” për shtetasin irakian të akuzuar për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” të kryer në bashkëpunim sipas nenit 298/3 të K.P. Nga analizimi i vendimit gjyqësor rezulton se ky shtetas ka vepruar në rolin e organizatorit duke qenë personi me rolin kyesor midis bashkëpunorëve të tjerë. Arsyetimi që ka dhënë Gjykata për të pranuar kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit personal, në këtë rast ka qenë i mbështetur në rrezikshmërinë e veprës penale si dhe rrezikun e prezumuar të largimit të personit nën hetim.

Nga tërësia e vendimeve të analizuara, vetëm në rastet e sipërcituara refugjatët e përfshirë në sjellje kriminale të lidhura me veprat penale të “Kalimi i paligjshëm i kufirit” parashikuar nga neni 297 K.P. dhe “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” parashikuar nga neni 298 K.P. kanë pasur statusin e azilkërkuesit⁶¹.

⁶⁰RAPORT STUDIMOR “Mbi të drejtat dhe liritë e emigrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri për periudhën 2012 - 2017” Komiteti Shqiptar i Helsinkit <https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2018/09/Migrantet-Shqip.pdf>

⁶¹ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Vendimi nr. 1477, datë 10.05.2021

1.4.1 Shqipëria vend tranzit apo destinacion?

Nisur nga vendimmarrjet e analizuara rezultojnë se migrantët e huaj, në momentin që janë marrë në pyetje për efekt të procesit dhe ndjekjes penale kanë dhënë informacion lidhur me itinerarin e ndjekur deri në mbërritjen në vendin tonë. Nga këto informacione rezultojnë se pjesa më e madhe e tyre deklarojnë se vijnë nga Siria, ndjekur nga shtetas maroken, afgan, palestinezë dhe irakian. Migrantët detyrohen të largohen nga vendet e tyre për shkak të situatës së luftës me të cilën përballen shtetet e tyre të origjinës. Ata largohen të organizuar në grupe që përbëhen nga 2 ose më shumë familje, si dhe në grupe me individë që i njohin ose për shkak të qëllimit të përbashkët për t'u larguar e kanë përshkruar bashku itinerarin e udhëtimit. Nga përpunimi i vendimeve gjyqësore rezultojnë se vetëm në 1 rast personi ishte larguar i vetëm nga vendi i tij i origjinës.⁶²

Sa i përket itinerarit të ndjekur deri në mbërritjen në territorin shqiptar, vihet re konsolidimi i rrugëve të kalimit të cilat përdoren nga emigrantët. Fillimisht ata shkojnë në shtetin turk dhe më pas kalojnë kufirin me shtetin grek dhe në vazhdim drejtohen për në juglindje të vendit tonë si vendkalimi i rradhës. Këto shtete përgjithësisht shërbejnë si vende tranziti dhe emigrantët në asnjë rast nuk kanë reflektuar qëllimin e tyre për të qëndruar në këto vende tranziti, por destinacioni i tyre mbeten vendet europiane. Por janë evidentuar edhe raste ku qëndrimi i emigrantëve në vende të ndryshme ka qenë më i zgjatur në kohë, duke mos shërbyer thjeshtë si një rrugë e shpejtë dhe e përkohshme tranziti. Në një rast emigrantët kanë qëndruar përkohësisht për rreth një muaj në qytetin e Selanikut (Greqi) kundrejt pagesës 400 euro, ndërsa në 2 raste të tjera janë nisur shumë vite më parë dhe kanë qëndruar në shtetin turk për 5 vite dhe në një rast tjetër për 7 vite. Rezultojnë se vetëm në një rast refugjatët kanë pasur një periudhë qëndrimi në një kamp në shtetin grek, që përkon me 20 ditë dhe më pas janë drejtuar për territorin shqiptar⁶³.

Në analizë të këtyre të dhënave apo edhe rrethanave të verifikuara nga gjykatat në vendimet gjyqësore, rezultojnë se shtetasit e huaj me qëllim për të kaluar në mënyrë tranzit drejt vendit të destinacionit, kërkojnë për persona të cilët mund t'i ndihmojnë për kalimin e kufijve. Nga tërësia e vendimeve të analizuara, nisur nga rrethanat e faktit të përshkruara vërehen 3 forma të ndërveprimit të tyre me kontrabanduesit:

- Refugjatët marrin takim me këta shtetas, të dyshuar si kontrabandues, pranë pikave të kalimit kufitar, ndërkohë që me ndihmën e këtyre të fundit mundësohet përfshirja e refugjatëve në grupe të tjera më të mëdha, të cilat kanë si qëllim të përbashkët të njëjtin destinacion;
- Refugjatët arrijnë të identifikojnë vetë mënyrat e komunikimit dhe vendndodhjet e kontrabanduesve, ose ndihmohen nga ana e personave të tjerë që ndodhen në shtetet fqinje, të cilët më herët kanë përdorur të njëjtën mënyrë për të kaluar në mënyrë të paligjshme në një tjetër territor shtetëror; t'i gjejnë vetë ose nëpërmjet personave të njohur që kanë në këto shtete,
- Refugjatët komunikojnë nëpërmjet rrjeteve sociale si facebook dhe whatsapp me kontrabanduesit. Kjo mënyrë komunikimi rezultojnë e përdorur në një masë më të gjerë, pasi në një sërë vendimesh të analizuara është konstatuar e provuar gjatë fazës së hetimeve paraprake se, refugjatët kanë kërkuar nëpërmjet rrjeteve sociale që të ndihmohen nëpërmjet njohjes me persona të caktuar ose nëpërmjet ndihmës që ju ofrohet për transport

⁶² Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec Vendimi nr.43-2021-430, date 26.04.2021

⁶³ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, Vendimi nr. 41-2021-945, datë 12.03.2021

me taksi. Pas identifikimit të personit, komunikimi vijon nëpërmjet aplikacionit whatsapp, ku shkëmbimi i lokacionit është më i lehtë.

Për ndihmën që marrin, për të kaluar tranzit drejt vendit të destinacionit, emigrantët paguajnë shuma monetare të caktuara, të cilat variojnë në varësi të destinacionit ku do të mbërrijnë, por edhe distancës së udhëtimit që do të përshkruhet. Nga përpunimi i vendimeve gjyqësore rezulton se në rastet kur kanë rënë dakord që ndihma t'u jepet deri në kalimin e kufirit shqiptar ata shoqërohen deri në kufi dhe më pas rrugën e vazhdojnë me ndihmën e orientimeve të marra nga sistemi i aplikacionit maps në aparatet e tyre celularë. Në këto raste rezulton të kenë paguar deri në 500 euro për person. Në momentin që mbërrijnë në shtetin shqiptar ata kërkojnë për makina të rastit që të mundën të vazhdojnë rrugën më tej. Për transportin drejt Tiranës, ose drejt një pike tjetër kufitare ata kanë paguar 100 euro deri në 220 euro.⁶⁴ Ndërkohë rezulton se shtetasit e huaj të cilët kalojnë tranzit në vendin tonë, e kanë të pamundur të aksesojnë shërbimet e transportit publik ndërqytetas. Arsyet lidhen me refuzimin e ofruesve të shërbimeve të transportit rrugor për t'i transportuar, për shkak të rasteve të ngjashme të cilat janë goditur nga ana e forcave ligjzbatuese, ndërkohë që ofruesit e këtyre shërbimeve në disa raste janë proceduar penalisht si autorë të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298 K.P.

Kur marrëveshja midis emigrantëve dhe personave të cilët do t'i transportojnë është bërë me qëllim që të interesuarit të arrijnë në destinacionin përfundimtar, pra në shtetin ku synojnë të vendosen përfundimisht, emigrantët përcillen dhe priten në kufijtë e çdo shteti nga persona me të cilët kanë komunikime të vazhdueshme deri sa mbërrijnë në vendin e synuar. Në këto raste ndihma u jepet nga grupe të mirëstrukturuara kriminale të cilat kanë aktivitetet ndërkombëtar të shtrirë në çdo shtet, apo grupe të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën dhe koordinojnë veprimet midis tyre për të bërë transportin brenda territorit, të kontrolluar prej tyre. Sa i takon mënyrës së pagesës, rezulton se emigrantët e kanë dhënë përnjëherësh në momentin e marrëveshjes, dhe vetëm në 2 raste e kanë bërë pjesërisht pas kalimit të çdo shteti, duke e dorëzuar tek personi që i ka shoqëruar shtetasit deri në kufi. I gjithë ky proces i kontrabandimit të migrantëve rezulton të karakterizohet nga një shkallë e lartë koordinimi, ndërkohë për dërgimin deri në destinacionin final rezulton të jenë paguar deri në 9000 euro për person⁶⁵.

Qëllimi dhe destinacioni përfundimtar i refugjatëve është mbërritja në një shtet të Bashkimit Europian për një jetesë më të mirë, ose për t'u bashkuar me familjarët që janë larguar drejt këtyre vendeve më parë, për shkak të luftës. Kështu shpesh herë si shtet i synuar prej tyre përmendet Gjermania. Shqipëria shihet si një vend kalimi tranzit për këta persona dhe vetëm në 1 rast ata kanë deklaruar se do të qëndronin për një periudhë kohore të përkohshme në Tiranë dhe kjo kishte të bënte me sigurimin e të ardhurave për të vijuar rrugëtimin drejt shteteve të tjera⁶⁶.

⁶⁴ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, Vendimi nr. 07/22-2015-78, datë 05.03.2015

⁶⁵ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Vendimi 41-2021-430,1284 datë 08.04.2021

⁶⁶ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Vendimi 41-2020-806 (58) date 02.03.2020

Rekomandime dhe Sugjerime:

1. KShH u sugjeron Prokurorive të rretheve gjyqësore në juridiksionin e Gjykatave, vendimet e të cilave janë studiuar, të vlerësojnë me kujdesin e duhur elementët që nxjerrin në pah format e veçantë të bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, me qëllim që hetimet për çështjen penale ti kalojnë menjëherë për kompetencë lëndore Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
2. KShH i sugjeron Gjykatave të shkallës së parë që t'i jepet përparësi zbatimit të ligjit specifik në rastet kur subjekt i veprës janë shtetasit e huaj në zbatim të ligjit nr.79/2021 "Për të huajt". Shtetasit e huaj duhet të konsiderohen si subjekt i largimit nga territori shqiptar dhe jo i ndëshkimit penal sipas legjislacionit tonë.
3. KShH u sugjeron Gjykatave që t'i kushtojnë më tepër vëmendje arsytimit të vendimeve gjyqësore, duke shmangur përdorimin e formateve tip dhe gjuhës standarte dhe formale që nuk bën të mundur arsyetimin e plotë, të qartë dhe logjik të vendimit si dhe individualizimin e drejtë të dënimit. I rekomandojmë gjykatave mbajtjen në konsideratë të parashtrimeve të argumentimeve ligjore të palëve dhe reflektimin e argumentave bindëse ligjore për pranimin ose refuzimin e tyre, mbështetur në mënyrë të individualizuar në rrethanat faktike të secilit rast. Vendimmarrjet gjyqësore vlerësojmë se duhet të kenë një analizë të qartë të elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit, në përputhje me konkretizimin me mos/veprimet e tyre.
4. KShH iu sugjeron institucioneve përgjegjëse si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës, koordinimin midis tyre me qëllim marrjen e masave konkrete në ndërtimin e planeve të veprimeve për aplikimin e politikave strategjike të miratuara për punësimin e të rikthyerve dhe shtetasve të dënuar për kalim të paligjshëm të kufirit për arsye punësimi, në favor të rritjes së mirëqenies së jetës së këtyre të fundit dhe riintegrimin më të lehtë e afatshkurtër të tyre në shoqëri.
5. KShH u sugjeron institucioneve përgjegjëse të sistemit të drejtësisë penale përmirësimin e zbatimit të politikës penale, nën qasjen humane, riintegruese dhe rehabilituese, lidhur me fenomenin e migrimit të paligjshëm, duke mbajtur në konsideratë faktorët nxitës dhe shtyrës, si dhe rrethanat socio-ekonomike me të cilat përballen personat nën hetim, elementë këto impaktues në fenomenin e recidivizmit.
6. KShH i sugjeron Drejtorisë së Përgjithshme të Kufirit dhe Migracionit, rritjen e cilësisë së mbikqyrjes kufitare, si dhe forcimin e bashkëpunimit e ndërveprimit me agjensi ndërkombëtare si FRONTEx në përputhje me legjislacionin kombëtar, si dhe direktivat ndërkombëtare siç është Strategjia e Bashkimit European mbi rikthimin vullnetar dhe riintegrimin.⁶⁷

⁶⁷ https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2021-04/27042021-eu-strategy-voluntary-return-reintegration-com-2021-120_en.pdf

Aneks 1- Lista e vendimeve të analizuara Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec

1. Vendim nr. 449 – 67 datë 29.04.2021
2. Vendim nr.650 – 121 datë 09.06.2021
3. Vendim nr.5 datë 11.01.2021
4. Vendim nr.32 datë 06.02.2021
5. Vendim nr.xxx⁶⁸ datë 16.01.2021
6. Vendim nr.43-2021-499 datë 07.05.2021
7. Vendim nr.43-2021-84 datë 26.01.2021
8. Vendim nr.43-2021-430 datë 26.04.2021
9. Vendim nr.146 datë 01.07.2021
10. Vendim nr.43-2021-75 datë 25.01.2021
11. Vendim nr.43-2021-518 datë 11.05.2021

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet

1. Vendim nr. 22-2018-62 datë 22.02.2018
2. Vendim nr. 22-2018-74 datë 05.03.2018
3. Vendim nr. 07/22-2015-78 datë 05.03.2015
4. Vendim nr. 22-2019-294 datë 29.07.2019
5. Vendim nr. 22-2019-184 datë 22.05.2019
6. Vendim nr. 22-2019-183 datë 22.05.2019

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

1. Vendim nr. 51-2021-1875 datë 26.04.2021
2. Vendim nr. 51-2021-175 datë 03.05.2021
3. Vendim nr. 51-2021-71 datë 18.01.2021
4. Vendim nr. 1179 datë 20.05.2021
5. Vendim nr. 55 datë 05.02.2021
6. Vendim nr. 1477 datë 10.05.2021

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë

1. Vendim nr. 41-2020-3744 (499) datë 24.12.2020
2. Vendim nr. 41-2020-3708(495) datë 22.12.2020
3. Vendim nr. 41-2021-1294(165) datë 09.04.2021
4. Vendim nr. 41-2021-1375(174) datë 15.04.2021
5. Vendim nr. 41-2021-945(128) datë 12.03.2021
6. Vendim nr. 41-2021-1284(163) datë 08.04.2021
7. Vendim nr. 41-2021-938(130) datë 12.03.2021
8. Vendim nr. 41-2021-2209(196) datë 26.06.2021
9. Vendim nr. 41-2021-1561(194) datë 27.04.2021

⁶⁸Për shkak të parimit të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale, ky vendim nuk ka pasur midis të dhënave të tjera si gjeneralitetet e personave, vendet, masën e shpërblimit as numrin e vendimit gjyqësor .

10. Vendim nr. 41-2020-806 (58) datë 02.03.2020
11. Vendim nr. 41-2020-1110(154) datë 14.05.2020
12. Vendim nr. 41-2020-732(56) datë 24.02.2020

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë

1. Vendim nr.23-2016-1616 (237) datë 06.09.2016
2. Vendim nr.23-2016-1632/243 datë 08.09.2016
3. Vendim nr.23-2016-1646/246 datë 13.09.2016
4. Vendim nr.23-2016-1763/266 datë 27.09.2016
5. Vendim nr.23-2016-1765(267) datë 27.09.2016
6. Vendim nr.23-2016-1845/281 datë 05.10.2016
7. Vendim nr.23-2016-1094(155) datë 31.05.2016
8. Vendim nr.23-2016-1925(287) datë 13.10.2016
9. Vendim nr.23-2016-1024/144 datë 20.05.2016
10. Vendim nr.23-2016-900/126 datë 03.05.2016
11. Vendim nr.23-2016-1930/289 datë 14.10.2016
12. Vendim nr.23-2016-1332(196) datë 01.07.2016
13. Vendim nr.23-2019-1762 datë 09.10.2019
14. Vendim nr. ⁶⁹ datë 15.01.2021
15. Vendim nr.70 (11) datë 15.01.2021
16. Vendim nr.23-2015-40 (9) datë 08.01.2016
17. Vendim nr.2 (1) datë 06.01.2021
18. Vendim nr.23-2020-744/151 datë 25.06.2020
19. Vendim nr.23-2019-751/153 datë 26.06.2020
20. Vendim nr.23-2020-790/159 datë 02.07.2020
21. Vendim nr.23-2020-845(166) datë 10.07.2020
22. Vendim nr.23-2020-878(170) datë 15.07.2020
23. Vendim nr.23-2020-897/173 datë 16.07.2020
24. Vendim nr.23-2020-908(175) datë 17.07.2020
25. Vendim nr.23-2020-910(176) datë 17.07.2020
26. Vendim nr.23-2020-911(177) datë 17.07.2020
27. Vendim nr.23-2020-959 datë 23.07.2020
28. Vendim nr.23-2020-960(183) datë 23.07.2020
29. Vendim nr.23-2020-961(184) datë 23.07.2020
30. Vendim nr.23-2020-1018(189) datë 30.07.2020
31. Vendim nr.23-2020-1069(196) datë 09.09.2020
32. Vendim nr.23-2020-1228(220) datë 02.10.2020
33. Vendim nr.23-2019-1287/225 datë 15.10.2020
34. Vendim nr.23-2020-1479/242 datë 04.12.2020
35. Vendim nr.23-2019-1639(240) datë 24.09.2019
36. Vendim nr.23-2019-1640(241) datë 24.09.2019
37. Vendim nr.23-2019-1641(242) datë 24.09.2019
38. Vendim nr.1669/250 datë 27.09.2019

⁶⁹ Ky vendim nuk ka pasur numër

39. Vendim nr.23-2019-1434(206) datë 31.07.2019
40. Vendim nr. ⁷⁰ datë 17.07.2018
41. Vendim nr.23-2019-1941/276 datë 30.10.2019
42. Vendim nr.23-2019-1964/278 datë 04.11.2019
43. Vendim nr.23-2019-1969/279 datë 04.11.2019
44. Vendim nr.23-2019-2329/308 datë 26.12.2019
45. Vendim nr.23-2019-2342(309) datë 27.12.2019
46. Vendim nr.23-2019-2343(310) datë 27.12.2019
47. Vendim nr.23-2019-2344(311) datë 30.12.2019
48. Vendim nr.23-2018-1901 datë 23.10.2018
49. Vendim nr.23-2018-1902/232 datë 23.10.2018
50. Vendim nr.23-2018-1903/233 datë 23.10.2018
51. Vendim nr.23-2018-2032(244) datë 08.11.2018
52. Vendim nr.23-2018-2027/243 datë 08.11.2018
53. Vendim nr.23-2018-2039/246 datë 09.11.2018
54. Vendim nr.23-2018-2068/249 datë 12.11.2018
55. Vendim nr.23-2018-2089(252) datë 13.11.2018
56. Vendim nr.23-2018-2123(257) datë 15.11.2018
57. Vendim nr.23-2018-2206(269) datë 27.11.2018
58. Vendim nr.23-2018-2409(301) datë 26.12.2018
59. Vendim nr.23-2017-637/102 datë 04.04.2017
60. Vendim nr.23-2017-654/104 datë 06.04.2017
61. Vendim nr. ⁷¹ datë 06.04.2017
62. Vendim nr.23-2017-674(109) datë 07.04.2017
63. Vendim nr.23-2017-686(110) datë 11.04.2017
64. Vendim nr.23-2017-842/129 datë 03.05.2017
65. Vendim nr.23-2017-857(133) datë 04.05.2017
66. Vendim nr.23-2017-860(135) datë 04.05.2017
67. Vendim nr.23-2017-905 datë 11.05.2017
68. Vendim nr.23-2017-1021(159) datë 31.05.2017
69. Vendim nr.23-2017-1057(168) datë 05.06.2017
70. Vendim nr.23-2016-1436(214) datë 15.07.2016
71. Vendim nr.23-2016-1484(220) datë 20.07.2016

⁷⁰ Ky vendim po ashtu

⁷¹ Ky vendim po ashtu